

REPubliKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRIA E FINANCAVE - MINISTARSTVO ZA FINANSIJE - MINISTRY OF FINANCE

Njësia për Inteligjencë Financiare - Finansijska Obavestanja Jedinica  
Financial Intelligence Unit

Nr./Br. FIUAD: 103/2023 Nr.faq./br.str. 4 shtojca

Data/Datum 12/04/2023

PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO



NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE  
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA  
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT

**Udhëzues (NjIF-K) Nr. 01/2023**

**për zbatimin e detyrimeve për parandalimin e pastrimit të parave  
dhe luftimit të financimit të terrorizmit (PPP/LFT)**

**për profesionistët ligjorë**

PRILL 2023

**Ky Udhëzues është hartuar me ndihmën e Projektit Kundër Krimin Ekonomik PECK III i cili është projekt i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës dhe zbatohet nga Këshilli i Evropës.**

## PËRMBAJTJA

<b>REPUBLIKA E KOSOVËS .....</b>	<b>1</b>
<b>REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO .....</b>	<b>1</b>
<b>1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>7</b>
<b>2 HYRJE.....</b>	<b>8</b>
<b>3 KORNIZA LIGJORE .....</b>	<b>9</b>
<b>4 STANDARDET NDËRKOMBËTARE.....</b>	<b>9</b>
4.1 FATF dhe kërkesat për bizneset dhe profesionet e përcaktuara jofinanciare, përfshirë profesionet ligjore .....	9
4.2 Korniza ligjore vendore.....	10
4.3 Qëllimi i udhëzuesit.....	11
4.4 Zbatimi .....	11
4.5 Privilegji ligjor .....	12
<b>5 PASTRIMI I PARAVE.....</b>	<b>12</b>
5.1 Përkufizimi i pastrimit të parave .....	13
5.2 Fazat e pastrimit të parave.....	13
5.3 Metodot e pastrimit të parave .....	14
5.4 Llojet e pastrimit të parave .....	16
5.5 Raste studimore të pastrimit të parave në sektorin ligjor .....	16
<b>6 FINANCIMI I TERRORIZMIT DHE FINANCIMI I PËRHAPJES .....</b>	<b>21</b>
6.1 Përkufizimi i financimit të terrorizmit .....	21
6.2 Metodot e përdorura për financimin e terrorizmit.....	21
6.3 Lidhja ndërmjet pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.....	22
6.4 Përkufizimi i financimit të përhapjes .....	22
<b>7 MASAT KYÇE QË DUHEN MARRË NGA SUBJEKTET RAPORTUESE PËR ZBATIMIN E DETYRIMEVE TË LIGJIT PPP/LFT .....</b>	<b>23</b>
7.1 Qasja e bazuar në rrezik dhe kontrollet e brendshme .....	23
7.1.1 Vlerësimi i rrezikut.....	24
7.1.2 Zbutja e rrezikut .....	29
7.1.3 Monitorimi i rrezikut .....	30
7.2 Politikat dhe procedurat për parandalimin e PP/FT/FP .....	31
7.2.1 Kriteret e vlerësimit-politikat dhe procedurat për parandalimin e PP/FT/FP .....	32
7.3 Emërimi i një zyrtari të pajtueshmërisë .....	33
7.3.1 Kriteret e vlerësimit - zyrtari i pajtueshmërisë.....	33
7.4 Trajnimi .....	34
7.4.1 Kriteret e vlerësimit-trajnimi .....	34
7.5 Auditimi i pavarur.....	35
7.5.1 Kriteret e vlerësimit- auditimi i brendshëm .....	35

<b>8</b>	<b>KUJDESI I DUHUR NDAJ KLIENTIT (KDK) .....</b>	<b>37</b>
8.1	Koha e identifikimit dhe verifikimit të klientit.....	37
8.1.1	Kriteret e vlerësimit-koha e identifikimit dhe verifikimit të klientit.....	37
8.2	Masat për kryerjen e kujdesit të duhur ndaj klientit.....	38
8.2.1	Masa për identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit të klientit.....	38
8.3	Personat e ekspozuar politikisht (PEP).....	40
8.3.1	Kriteret e vlerësimit - Personat e ekspozuar politikisht.....	41
8.4	Kujdesi i duhur i shtuar .....	42
8.4.1	Kriteret e vlerësimit, kujdesi i duhur i shtuar .....	43
8.5	Kujdesi i duhur i thjeshtësuar .....	43
8.5.1	Kriteret e vlerësimit - kujdesi i duhur i thjeshtësuar .....	44
<b>9</b>	<b>MONITORIMI DHE RAPORTIMI I VAZHUESHËM .....</b>	<b>45</b>
9.1	Monitorimi dhe raportimi i vazhdueshëm.....	45
9.1.1	Kriteret e vlerësimit-monitorimi dhe raportimi i vazhdueshëm .....	45
9.2	Transaksione të ndërlikuara, të pazakonta dhe të mëdha .....	45
9.2.1	Kriteret e vlerësimit - transaksione të ndërlikuara, të pazakonta dhe të mëdha.....	46
9.3	Raportimi i transaksioneve tek NjIF-i .....	46
9.3.1	Kriteret e vlerësimit-raportimi në NjIF.....	47
<b>10</b>	<b>MBAJTJA E SHËNIMEVE .....</b>	<b>47</b>
10.1	Mbajtja e shënimeve .....	47
10.2	Kriteret e vlerësimit: mbajtja e shënimeve.....	48
<b>11</b>	<b>DEGËT DHE FILIALET E HUAJA .....</b>	<b>48</b>
11.1	Kërkesat e LPP/LFT-së zbatohen për degët dhe filialet e huaja .....	48
11.2	Kriteret e vlerësimit – Degët dhe filialet e huaja.....	49
<b>12</b>	<b>MONITORIMI I FINANCIMIT TË TERRORIZMIT DHE FINANCIMIT TË PËRHAPJES .....</b>	<b>51</b>
12.1	Monitorimi i FT/FP-së .....	51
12.2	Kriteret e vlerësimit Monitorimi i FT-së dhe FP-së .....	51
<b>13</b>	<b>ÇFARË DUHET PRITUR GJATË NJË INSPEKTIMI TË SIPAS LIGJIT PËR PPP/LFT .....</b>	<b>53</b>
13.1	Çfarë duhet pritur nga stafi i autoritetit mbikëqyrës.....	53
13.2	Kërkesat për informacion nga autoriteti mbikëqyrës .....	53
13.3	Gjatë inspektimit në terren .....	53
13.4	Çfarë do të kontrollohet .....	54
13.5	Sanksionet për mos-pajtueshmëri.....	54
<b>14</b>	<b>LISTA E SHTOJCAVE.....</b>	<b>55</b>
14.1	SHTOJCA 1 – CENUESHMËRITË E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT PËR PROFESIONISTËT LIGJOR.....	55
14.2	SHTOJCA 2 – KLIENTI, SHËRBIMET DHE RREZIKU GJEOGRAFIK PËR PROFESIONISTËT LIGJOR.....	61

Rreziku gjeografik .....	61
Rreziku i klientit .....	61
Rreziku i transaksionit/shërbimit .....	65
14.3 SHTOJCA 3 - LISTA KONTROLLUESE E VLERËSIMIT TË RREZIKUT.....	69
14.4 SHTOJCA 4 - MASAT PËR ZBUTJEN E RREZIKUT.....	83
<b>13. KONKLuzionet.....</b>	<b>84</b>
<b>14. Bibliografia.....</b>	<b>85</b>

## SHKURTESAT

<b>PPP/LFT</b>	Parandalimi i Pastrimit të Parave/Luftimi i Financimit të Terrorizmit
<b>Ligji PPP/LFT</b>	Ligji Nr. 5/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit
<b>QBRr</b>	Qasja e Bazuar në Rrezik
<b>KDK</b>	Kujdesi i Duhur ndaj Klientit
<b>SPR</b>	Standardi i Përbashkët i Raportimit
<b>BPPjF</b>	Biznese dhe Profesione të Përcaktuara Jo-Financiare
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>FATF</b>	Task Forca për Veprim Financiar
<b>NjIF</b>	Njësia për Inteligjencë Financiare
<b>AZL</b>	Agjencitë e Zbatimit të Ligjit
<b>PP</b>	Pastrimi i Parave
<b>OBZHE</b>	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
<b>PEP</b>	Persona të Ekspozuar Politikisht
<b>FT</b>	Financimi i Terrorizmit
<b>UNODC</b>	Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krime

## 1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky udhëzues synon të ndihmojë profesionistët ligjorë në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas Ligjit Nr. 5/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji PPP/LFT) duke u mundësuar që të kuptojnë rreziqet e PP/FT që ekzistojnë në sektorin e tyre dhe të zbatojnë një qasje të bazuar në rrezik ndaj detyrimeve të tyre për LPP/LFT. Qasja e bazuar në rrezik është thelbësore për zbatimin efektiv të kornizës për LPP/LFT.

Udhëzuesi ka për Qëllim të kuptuarit më të mirë të rrezikut të PP/FT nga subjektet raportuese në një sektor që vlerësohet nga vlerësimi kombëtar i rrezikut se kishte një cenueshmëri më të lartë të PP/FT<sup>1</sup>.

Dokumenti është strukturuar për t'u ofruar profesionistëve ligjorë një përmbledhje të koncepteve kyçe të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, rrezikut dhe sfidave ndaj të cilave mund të ekspozohen profesionet ligjore, të ofrojë raste studimore të rasteve të PP/FT në profesionin ligjor si dhe të nxjerrë në pah hapa konkretë se si këto mund të zbuten dhe menaxhohen në mënyrë efektive. Detyrimet për LPP/LFT janë të përmbledhura dhe të shoqëruara me kritere vlerësimi që shpjegojnë se çfarë pret NjIF-K gjatë kryerjes së inspektimeve. Këto kritere vlerësimi u ofrojnë profesionistëve ligjorë një pasqyrë të qartë se çfarë duhet bërë kur zbatojnë detyrimet e tyre për LPP/LFT.

Tutje, udhëzuesi thekson përgjegjësinë e rëndësishme të menaxhmentit të lartë të profesioneve ligjore për të nxitur dhe promovuar një kulturë të pajtueshmërisë. Ai gjithashtu shpjegon detyrimet për profesionistët ligjorë në lidhje me identifikimin dhe verifikimin e informacionit të pronësisë përfituese dhe ofron shembuj se si të zbatohen masat standarde, të thjeshtuara dhe të zgjeruara të kujdesit të duhur ndaj klientit bazuar në rrezikun e PP/FT-së. Udhëzuesi thekson nevojën për trajnim dhe ndërgjegjësim si për profesionistët ligjorë ashtu edhe për DNFBP-të e tjera për të zbatuar në mënyrë efektive kërkesat e LPP/LFT-së.

---

<sup>1</sup> VRrK-ja e Kosovës ka identifikuar noterët si subjekte raportuese me cenueshmëri më të lartë. Ndërsa, avokatët u konsideruan të kishin një cenueshmëri më të ulët. *Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar të Kosovës për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit*, gusht 2020.

## 2 HYRJE

Zhvillimi i këtij udhëzuesi për zbatimin e detyrimeve të LPP/LFT për profesionistët ligjorë synon t'u ofrojë profesionistëve ligjorë këshilla konkrete se si të identifikojnë rrezikun e PP/FT në sektorin e tyre dhe si të zbatojnë në mënyrë efektive masat parandaluese në proporcion me rrezikun.

Dokumenti së pari ofron një pasqyrë të standardeve ndërkombëtare, duke përfshirë rekomandimet përkatëse të FATF-së dhe kornizën legislative kombëtare LPP/LFT në Kosovë, përfshirë edhe aty ku obligimet e LPP/LFT shtrihen edhe tek profesionistët ligjorë. Dokumenti gjithashtu përshkruan kufizimet e privilegjit ligjor (sekretit profesional) kur profesionistëve ligjorë u kërkohet të zbatojnë masat LPP/LFT. Seksioni 5 prezanton konceptet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në profesion, duke përfshirë fazat e PP/FT-së. Rastet studimore sektoriale dhe treguesit e rrezikut janë përfshirë për të ndihmuar profesionistët ligjorë të kuptojnë se si profesioni i tyre mund të abuzohet nga kriminelët dhe financuesit e terrorizmit.

Seksionet vijuese të udhëzuesit fokusohen në ofrimin e një përmbledhjeje të detyrimeve të profesionistëve ligjorë për LPP/LFT. Kapitujt e veçantë diskutojnë detyrimet që lidhen me zbatimin e qasjes së bazuar në rrezik dhe kontrollat e brendshme, kujdesin e duhur ndaj klientit (KDK), mbajtjen e të dhënave, monitorimin e vazhdueshëm dhe sanksionet e monitorimit të FT dhe përhapjes. Këto seksione parashikojnë gjithashtu kritere vlerësimi për çdo kategori detyrimi. Këto kritere vlerësimi paraqesin pritjet e NjIF-K-së gjatë kryerjes së inspektimeve dhe u ofrojnë profesionistëve ligjorë udhëzime konkrete se si të zbatojnë obligimet specifike. Seksioni i fundit i udhëzuesit detajon se çfarë mund të presin profesionistët ligjorë kur i nënshtrohen një inspektimi të LPP/LFT-së.

Shtojcat janë përgatitur për t'u ofruar profesionistëve ligjorë këshilla konkrete se si të konstatojnë rrezikun e PP/FT brenda subjekteve të tyre.

**Shtojca 1** ofron një listë me flamuj të kuq dhe tregues që do të ndihmojnë profesionistët ligjorë në identifikimin e transaksioneve të dyshimta.

**Shtojca 2** ofron një listë të situatave me rrezik më të lartë që përfshijnë klientët, shërbimet dhe transaksionet dhe rrezikun gjeografik që do të mbështesë profesionistët ligjorë në kryerjen e vlerësimit të rrezikut të aktiviteteve të tyre.

Së fundi, **Shtojca 3** ofron një mjet për vlerësimin e rrezikut që mund të ndihmojë profesionistët ligjorë në kryerjen e vlerësimit të rrezikut të PP/FT të aktiviteteve të subjektit të tyre me kontrolle të propozuara për të ndihmuar në zbutjen e rreziqeve të identifikuara.



### 3 KORNIZA LIGJORE

Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit përfshijnë veprime që përfaqësojnë një kërcënim për stabilitetin dhe integritetin e sistemit financiar, i cili në terma afatgjatë dobëson besimin e qytetarëve në parimet demokratike të një shoqërie moderne, si në nivel global ashtu edhe në atë kombëtar, dhe çon në nevojën e shtuar për mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemit financiar me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të aktiviteteve të ndërlidhura me PP/FT/FP.

Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është një hap shumë i ndërlikuar dhe sfidues në kohën tonë moderne që kërkon bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar gjatë gjithë procesit të zbatimit: ndërgjegjësimi, zbulimi, hetimi, sekuestrimi i pasurive, ndjekja penale dhe konfiskimi/rikthim i fondeve.

Ndikimi ekonomik dhe politik i organizatave kriminale dobëson vlerat shoqërore, standardet etike dhe, së fundi, institucionet e një shoqërie moderne demokratike. Gjithashtu, pastrimi i parave ndikon negativisht në treguesit ekonomikë dhe kontribuon në dobësimin e rritjes ekonomike.

Ky udhëzues është nxjerr bazuar në paragrafin (1.11) të nenit 14 dhe paragrafin 2 të nenit 66 të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit dhe (Ligji LPP/LFT) dhe në konsultim me autoritetet mbikëqyrëse të LPP/LFT-së, me qëllim të sigurimit të një zbatimi uniform të detyrimeve të LPP/LFT-së nga subjektet raportuese.

### 4 STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) përcaktojnë një kornizë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të masave që vendet duhet të zbatojnë për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Vendet kanë korniza të ndryshme ligjore, administrative dhe operacionale dhe sisteme të ndryshme financiare, dhe kështu nuk mund të marrin të gjitha masa të njëjta për t'iu kundërvënë këtyre kërcënimeve. Prandaj, rekomandimet e FATF-së përcaktojnë një standard ndërkombëtar, të cilin vendet duhet ta zbatojnë përmes masave të përshtatura për rrethanat e tyre të veçanta.

#### 4.1 FATF dhe kërkesat për bizneset dhe profesionet e përcaktuara jofinanciare, përfshirë profesionet ligjore

Standardet e FATF-së përshkruajnë masat parandaluese që duhet të respektojnë si sektori financiar ashtu edhe ai jofinanciar. Në Rekomandimet 22 dhe 23, FATF u bën thirrje DNFBP-ve duke përfshirë profesionistët ligjorë, për të përmbushur kërkesat që lidhen me:

- Kujdesin e duhur ndaj klientit (KDK);
- Mbajtjen e shënimeve;
- Personat e ekspozuar politikisht;

- Teknologjitë e reja;
- Mbështetjen tek palët e treta;
- Raportimin e transaksioneve të dyshimta;
- Kontrollet e brendshme;
- Vendet me rrezik më të lartë;
- Mos-zbulimi i informatës dhe konfidencialitetin.

Standardet e FATF-së ofrojnë bazën mbi të cilën është krijuar korniza legislative e Kosovës për LPP/LFT.

#### 4.2 Korniza ligjore vendore

Qëllimi i luftimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes (PP/FT/FP) është të parandalojë dhe zbulojë aktivitetet e përdorura për të fshehur burimin e vërtetë të parave ose pasurive të tjera që dyshohet se janë përfituar në mënyrë të paligjshme. Kosova e njeh cenueshmërinë e sektorëve financiarë dhe jofinanciar ndaj PP/FT/FP.

Për këtë qëllim, Ligji Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (Ligji PPP/LFT) ka krijuar disa detyrime dhe ka bartur disa të drejta për personat juridikë dhe fizikë që operojnë në këta sektorë specifikë në luftën kundër PP/FT/FP.

Detyrimet për LPP/LFT janë specifikuar më tej në aktet nënligjore dhe rregulloret e mëposhtme:

Lista e subjekteve raportuese që duhet të zbatojnë detyrimet për LPP/LFT përfshin <sup>2</sup>:

Institucionet financiare:

- Bankat;
- Institucionet financiare
  - Zyrat e këmbimit valutor;
  - Shërbimet e transferimit të parave dhe vlerës ;
  - Kompanitë e sigurimit;
  - Institucionet mikrofinanciare;
  - Institucionet financiare jobankare (për Kreditim, Lizing, Pagesa, Transfere, Kembim dhe Emetim të Parasë Elektronikë);
  - Fondet e pensioneve.

BPPjF:

- Noterët;
- Avokatët;

<sup>2</sup> Neni 16 i Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

- Auditorët e pavarur dhe firmat audituese;
- Kontabilistët e pavarur dhe firmat e kontabilitetit;
- Kazino përfshirë kazinotë në internet;
- Agjentët/agjencitë e pasurive të patundshme;
- Trustin dhe ofruesit e shërbimeve të kompanisë;
- Tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuar;
- Tregtarët e mallrave që marrin pagesa në para të gatshme prej 10,000 euro ose më shumë.

Luftimi i PP/FT/FP kërkon që të gjitha subjektet raportuese të zbatojnë në mënyrë efektive masat e përshkruara në udhëzues për të minimizuar rrezikun që kriminelët të gjejnë hallkën më të dobët ose të përdorin kanale të reja për keqpërdorim të sistemit financiar.

#### 4.3 Qëllimi i udhëzuesit

Ndërgjegjësimi për detyrimet është një komponent kritik për parandalimin e PP/FT nga subjektet raportuese. Udhëzuesi është nxjerrë me qëllim të ndihmës së profesionistëve ligjorë në përmbushjen e detyrimeve të tyre dhe lehtësimin e zbatimit të masave të nevojshme legislative dhe rregullative për të parandaluar keqpërdorimin e sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë. Si pjesë e obligimeve të tyre sipas Ligjit PPP/LFT dhe rregulloreve në vijim, të gjithë profesionistëve ligjorë që kryejnë aktivitetet e përcaktuara u kërkohet të zbatojnë masat e listuara në Ligjin LPP/LFT duke përfshirë katër kategori të gjera të kërkesave të përshkruara në nenin 4 të këtij udhëzuesi.

Profesionistët ligjorë janë gjithashtu të detyruar që procedurat e përshkruara në këtë udhëzues t'i harmonizojnë me udhëzimet e vlefshme të miratuara nga organet kompetente mbikëqyrëse dhe vetërregulluese.

#### 4.4 Zbatimi

Ky udhëzues zbatohet për avokatët dhe noterët kur ata përgatiten të kryejnë ose angazhohen në transaksione për klientin e tyre në lidhje me aktivitetet e poshtëshënuara. Për qëllime të këtij udhëzuesi, sikurse është përcaktuar me Ligjin për PPP/LFT, transaksion konsiderohet mes tjerash, por nuk është i kufizuar vetëm në aktivitetet e listuara si në vijim:

- Blerjen dhe shitjen e pasurive të patundshme;
- Menaxhimin e parave të klientit, letrave me vlerë ose pasurive të tjera të klientit;
- Menaxhimin e llogarive bankare, kursimeve ose të letrave me vlerë;
- Organizimin e kontributeve të nevojshme për krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive; dhe
- Krijimin, funksionimin ose menaxhimin e personave ose marrëveshjeve ligjore dhe blerjen dhe shitjen e subjekteve afariste.

#### 4.5 Privilegji ligjor

Profesionistët ligjorë nuk i nënshtrohen detyrimeve të LPP/LFT kur konstatojnë pozitën juridike të klientit të tyre, ose në kryerjen e detyrës së tyre për mbrojtjen ose përfaqësimin e atij klienti në, ose në lidhje me procedurat gjyqësore, administrative, të arbitrazhit ose ndërmjetësimit. Neni 31 (7) i Ligjit LPP/LFT përcakton shprehimisht se: "Avokati nuk jep informacione të cilat i ka marrë nga klienti ose i ka mësuar për klientin, për ta përfaqësuar klientin në procedurë penale apo gjyqësore pa autorizim nga klienti ose me urdhër të gjykatës, përveç nëse avokati me arsye beson se klienti kërkon këshillë ose ndihmë nga avokati për të kryer një vepër penale".

Avokatët dhe noterët nuk i nënshtrohen privilegjit profesional (sekretit profesional) kur përgatiten për kryerjen ose përfshirjen në transaksione për klientin e tyre. Në bazë të nenit 16 (1.6) të Ligjit LPP/LFT, këto aktivitete përfshijnë:

- Blerjen dhe shitjen e pasurive të patundshme;
- Menaxhimin e parave të klientit, letrave me vlerë ose pasurive të tjera të klientit;
- Menaxhimin e llogarive bankare, kursimeve ose të letrave me vlerë;
- Organizimin e kontributeve të nevojshme për krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive; dhe
- Krijimin, funksionimin ose menaxhimin e personave ose marrëveshjeve ligjore dhe blerjen dhe shitjen e subjekteve afariste.

Neni 63 i Ligjit PPP/LFT parashikon që sekreti profesional nuk përdoret si bazë për refuzimin e dhënies së informacionit që do të zbulohet në përputhje me Ligjin PPP/LFT, duke përfshirë raportimin e transaksioneve të dyshimta ose informacionet që mblidhen dhe mbahen në përputhje me këtë ligj dhe kërkohet nga NjIF-i ose policia në lidhje me një hetim që ka të bëjë me PP/FT të urdhëruar nga, ose të kryer nën mbikëqyrjen e prokurorit ose gjyqtari të procedurës paraprake.

Ky udhëzues do të donte të theksonte se nëse nuk jeni të sigurt për detyrimet tuaja kur bëhet fjalë për detyrën tuaj të konfidencialitetit dhe pretendimin për privilegj ligjor mbi komunikimet në një situatë të caktuar, duhet të konsideroni të kërkonit këshilla të pavarura ligjore dhe/ose të kontaktoni organin tuaj profesional përkatës.

## 5 PASTRIMI I PARAVE

Objektivi i këtij seksioni është t'u japë subjekteve raportuese një kuptim bazë të koncepteve kryesore të pastrimit të parave duke e përcaktuar, apo duke e përshkruar atë si një proces me tre faza dhe të ofrojnë një përmbledhje të shkurtër të disa prej metodave më të përdorura të pastrimit të parave.

## 5.1 Përkufizimi i pastrimit të parave

Sipas nenit 56 të Ligjit për PPP, pastrimi i parave përkufizohet si:

*Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me veprë penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin IX të Kodit të procedurës penale të Kosovës, zhvillon veprimet e mëposhtme, kryen veprë penale të dënueshme me burgosje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale, si vijon:*

*1.1. konvertton, transferon ose përpiqet të konvertojë ose të transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë;*

*1.2. konvertton, transferon ose përpiqet të konvertojë ose të transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në të ose që, siç pandehet, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e pasojave ligjore apo të pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij;*

*1.3. konvertton, transferon ose përpiqet të konvertojë ose të transferojë pasurinë me qëllim të nxitjes së aktivitetit të ndërlidhur kriminal;*

*1.4. merr, posedon, shfrytëzon apo tenton të merr, posedojë apo shfrytëzojë pasurinë;*

*1.5. fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me, apo pronësinë e pasurisë, ose nga një akt i pjesëmarrjes në veprimtari të tilla;*

*1.6. merr pjesë në, bashkëpunon dhe ndihmon për të kryer, nxit, lehtëson dhe këshillon në kryerjen e ndonjë prej veprimeve të përmendura në nën-paragrafët 1.1 deri në 1.5. të këtij paragrafi;*

Veprimtaria kriminale i paraprin gjithmonë veprës së pastrimit të parave, domethënë fshehjes së burimit të vërtetë të të ardhurave nga krimi dhe të gjithë pasurisë që rrjedh nga ato të ardhura.

## 5.2 Fazat e pastrimit të parave

Procesi i pastrimit të parave përshkruhet në tre faza:

- **Vendosja:** fondet që rrjedhin nga aktivitetet kriminale (për shembull, tregtia e drogës) futen (vendosen) për herë të parë në sistemin financiar ose përdoren për të blerë mallra ose prona me vlerë të lartë. Në këtë fazë, të ashtuquajturat “para të pista” janë më të dukshme dhe më të ekspozuara ndaj zbulimit.

#### Shembull i profesionistit ligjor të përfshirë në fazën e vendosjes:

- Një kriminel i kërkon avokatit të hapë dy llogari bankare kursimi në banka të ndryshme – Banka A dhe Banka B
- Nga të ardhurat e veprës penale, kriminelin bën depozita të rregullta parash në çdo llogari në të dyja bankat dhe kërkon që avokati t'i bëjë ato depozita në emër të tij.

- **Shtresimi:** në këtë fazë, fondet shtresohen dhe vendosen në flukse financiare. Kryerja e transaksioneve të ndërlikuara është një përpjekje për të fshehur, në mënyrë të ndryshme, burimin e fondeve të fituara në mënyrë të paligjshme ose pronarin e fondeve. Në këtë fazë, zbulimi i "parave të pista" bëhet më i ndërlikuar.

#### Shembull i profesionistit ligjor të përfshirë në fazën e shtresimit:

- Profesionisti ligjor ndihmon kriminelin që të investojë fondet në letra me vlerë duke përdorur fondet e grumbulluara në llogarinë e Bankës A
- Krimineli blen një shtëpi, me ndihmën e një profesionisti ligjor, duke përdorur një kredi hipotekare të marrë në Bankën B. Ndërsa, letrat me vlerë dhe kursimet e tij në Bankën A përdoren si depozitë në shtëpi.
- Krimineli e shet pronën përmes një profesionisti ligjor

- **Integrimi:** në këtë fazë paraja e pistë arrin qëllimin e saj kur integrohet në sistemin financiar si pjesë e fluksit të fondeve legjitime, duke iu bashkangjitur instrumenteve apo vlerave të tjera financiare brenda sistemit financiar të vendit, duke e bërë kështu zbulimin thuajse të pamundur.

#### Shembull i profesionistit ligjor të përfshirë në fazën e shtresimit:

- Pasi ka depozituar para në bankë në fazën e vendosjes dhe ka kryer një sërë transaksionesh financiare në fazën e shtresimit, në fazën e integrimit, kriminelin blen një biznes të ligjshëm nëpërmjet një profesionisti ligjor.

### 5.3 Metodave të pastrimit të parave

Krahas zhvillimeve teknologjike, ka edhe një rritje të numrit të metodave të sofistikuara dhe të ndërlikuara të përdorura për fshehjen e origjinës së pasurisë së përfituar në mënyrë të paligjshme. Nga një numër i madh metodash, më poshtë janë disa nga ato që përdoren më shpesh nga "pastruesit" që përpiqen të anashkalojnë zbulimin:

**Transaksione të shumta** – nëse i njëjti person në një ditë kryen dy ose më shumë transaksione, dhe shtimi total i transaksioneve në një ditë tejkalon kufirin e përcaktuar për identifikim ose raportim në NjIF-K.

**Kompani false** – të ashtuquajturat “kompani guaskë” fshehin fondet e pastruara ndërsa “front kompanitë” kryejnë aktivitete të ligjshme biznesi për të fshehur pastrimin e parave. Kjo metodë përdoret shpesh në fazën e shtresimit ndërsa vetë procedura e pastrimit të parave mund të kryhet në disa vende.

**Kazinotë** – një person blen zhetonët e kazinosë me para të gatshme, luan disa seri me pak zhetonë dhe kërkon pagesën e shumicës së zhetonëve të mbetur të cilët ai/ajo i depoziton më vonë në llogarinë e personave të tretë.

**Përdorimi i një aksionari të emëruar** – kjo është metoda më e përdorur për pastrimin e parave në fazën e vendosjes. Një person që dëshiron të fusë para të pista në sistemin financiar mund të përpiqet të fshehtë origjinën e pronës së fituar në mënyrë të paligjshme duke angazhuar "aksionarë të emëruar" si anëtarët e familjes, miqtë ose bashkëpunëtorët e biznesit që gëzojnë besimin e komunitetit dhe kryejnë transaksione në emër të tij/saj. Në këtë mënyrë i emëruari mund të shmangë më lehtë zbulimin e burimit të parave të pista nga subjektet raportuese.

**Strukturimi** – Smurfingu përfshin strukturimin e shumave më të mëdha të parave të gatshme, mbi kufirin e ligjshëm për mbajtjen dhe raportimin e të dhënave, në një shumë më të vogël të transaksionit të parave të gatshme për vendosje në sistemin financiar. Pastruesi mund të përdorë shumë "smurfë" për të strukturuar paratë e tij të pista. Duke strukturuar depozitën më të madhe të parave të gatshme në depozita më të vogla, shpesh të depozituara nga shumë "smurfë", pastruesi përpiqet të shmangë disa metoda zbulimi të krijuara si pjesë e regjimit të PP/FT-së si: detyrimin për të raportuar për transaksionet me para të gatshme mbi një shumë të caktuar dhe detyrimin për identifikimin e klientit. Për këto arsye, "smurfët" përdoren shpesh në procesin e PP/FT-së.

**Blerja e pronës me para të gatshme** - gjatë blerjes së mallrave me vlerë të lartë ose produkteve luksoze (xhevahire, automjete, jahte dhe të ngjashme), si dhe pasuri të paluajtshme dhe tokë duke përdorur para të gatshme, më së shpeshti prona regjistrohet në emër të një bashkëpunëtori të afërt ose të një të afërmi me qëllim të fshehjes së pronarit përfitues. Prona gjithashtu rishitet shpesh për të fshehur origjinën e saj të vërtetë dhe pronarin e saj përfitues.

**Ri-blerja** – Fondet e blera në mënyrë të paligjshme përdoren për blerjen e valutës së huaj, e cila më pas transferohet shpesh në llogaritë bankare në qendrat financiare offshore në mbarë botën.

**Ri-destinim** - emetime më të vogla të fondeve të përfituara në mënyrë të paligjshme, të tilla fonde të fituara përmes trafikut të drogës në rrugë, ndryshohen me emetime më të mëdha për qëllime fshehjeje në lëvizjet ndërkuftare.

Subjektet raportuese duhet t'u referohen burimeve të ndryshme si udhëzimet nga NjIF-i, informacionet nga organet e tyre profesionale dhe të përditësojnë njohuritë e tyre për tendencat dhe tipologjitë e pastrimit të parave nga NjIF-i, Task Forca e Veprimit Financiar, dhe organe të tjera ndërkombëtare.

#### 5.4 Llojet e pastrimit të parave

Zakonisht ekzistojnë tre lloje të pastrimit të parave:

Vetëpastrimi - Kur një shkelës thjesht vepron për të pastruar të ardhurat e veprës së tij/saj.

Pastrimi ndërmjet palëve të treta (3PML) – Kur pastrimi kryhet nga një person i ndryshëm nga autori i veprës kryesore. Individë, profesionistë ose biznese që shpesh qëndrojnë jashtë sektorëve financiarë dhe jofinanciar, por shfrytëzojnë shërbime ose produkte që paraqesin rrezik më të lartë abuzimi për pastrim parash.

Pastrimi i pavarur<sup>3</sup>- Këto janë raste kur çështja e pastrimit të parave vazhdon pa u vërtetuar vepra kryesore. Vepra e pastrimit të parave trajtohet si një krim më vete. Autoritetet nuk duhet të dëshmojnë se fondet janë të ardhura të një vepre penale të caktuar, por bazuar në prova të mjaftueshme rrethanore, mund të vërtetojnë se të ardhurat kishin origjinë kriminale.

#### 5.5 Raste studimore të pastrimit të parave në sektorin ligjor<sup>4</sup>

Seksioni në vijim do të përshkruajë rastet praktike ku avokatët dhe noterët janë përdorur për të lehtësuar procesin e pastrimit të parave.

##### **Rasti 1 – Profesionisti ligjor parashtron RTD, pasi ka vërejtur tregues të flamujve të kuq në transaksionin e pronës**

NjIF-i i Belgjikës mori një njoftim nga një noter për një person nga Evropa Lindore, i cili banonte në Belgjikë dhe kishte blerë një pronë atje.

Blerja ka ndodhur duke depozituar çmimin total të blerjes në para të gatshme përpara se të nënshkruhet dokumenti që vërteton blerjen. Personi pretendoi se nuk mund të hapte një llogari bankare dhe kështu duhej të paguante pronën me para të gatshme.

Pas njoftimit të noterit, NjIF-i mësoi se personi kishte një llogari në një bankë Belge dhe se madhësia e transaksionit nuk ishte në përputhje me gjendjen e tij financiare pasi në të njëjtën kohë ai po merrte përfitime shtetërore. Burime policore bënë me dije se personi njihej

<sup>3</sup> Sipas Direktivës së Bashkimit Evropian (BE) 2018/1673 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 tetor 2018 për luftën kundër pastrimit të parave sipas ligjit penal, pastrimi i parave mund të konsiderohet si veprë autonome (pastrim parash i pavarur). Një dënim duhet të jetë i mundur pa qenë e nevojshme të përcaktohet saktësisht se nga cila veprimtari kriminale është krijuar pasuria, ose të ketë një dënim të mëparshëm ose të njëkohshëm për atë veprimtari kriminale, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat përkatëse.

<sup>4</sup> Rastet studimore të përfshira në këtë seksion janë nxjerrë nga Raporti FATF (2013) – Cenueshmëritë e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për profesionistët ligjorë.



për trafik të paligjshëm mallrash dhe shërbimesh.	
<b>Rasti 1</b>  <b>Treguesit e flamurit të kuq:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Transaksioni përfshin një sasi jo-proporcionale financimi/parash të gatshme private, i cili nuk është në përputhje me profilin social-ekonomik të individit</li> <li>• Transaksioni është i pazakontë për shkak të mënyrës së ekzekutimit - në këtë rast ishte depozitimi i çmimit total të blerjes aq herët në transaksion, i cili ishte i ndryshëm nga zakonet normale.</li> </ul>

**Rasti 2: Profesionisti ligjor lehtëson shitjet e shumëfishta të njëpasnjëshme të pronave brenda një grupi mashtruesish hipotekash**

Një individ në fillim të të 20-ave që punonte si kopshtar iu drejtua një noteri për të blerë disa prona të paluajtshme. Klienti këshilloi se po financonte blerjet nga shitjet e mëparshme të pronave të tjera dhe dha një çek bankar për të paguar çmimin e blerjes.

Më pas klienti udhëzoi një grup të ndryshëm noterësh që të rishitnin pronat me një çmim më të lartë shumë shpejt pas blerjes së parë. Pronat iu shitën njerëzve të tjerë që klienti i njihnte, të cilët ishin gjithashtu në fillim të të 20-tave dhe kishin punë të ngjashme me pagesë të ulët.

Klienti në fakt kishte marrë hipotekë duke përdorur dokumente false për këto prona, dhe duke gjeneruar të ardhura nga krimi. Shitjet e shumta ndihmuan në pastrimin e këtyre fondeve.

<b>Rasti 2</b>  <b>Treguesit e flamurit të kuq:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shuma disproporcionale e financimit privat që është në kundërshtim me profilin social-ekonomik të individit dhe profilin e palëve.</li> <li>• Transaksionet janë të pazakonta sepse nuk janë në përputhje me moshën dhe profilin e palëve.</li> <li>• Paraqitjet e shumta të të njëjtave palë në transaksione brenda një periudhë të shkurtër kohore.</li> <li>• Transaksion pronësor i një-pas-një-shëm (ose ABC), me vlerë në rritje me shpejtësi.</li> <li>• Klienti ndryshon këshilltarin ligjor disa herë në një hapësirë të shkurtër kohore pa arsye legjitime.</li> <li>• Klienti ofron dokumentacion të rremë.</li> </ul>
---	--

### **Rasti 3: PEP i përfshirë në keqbërje financiare blen prona të shtrenjta në një vend të huaj përmes subjektit korporativ**

Një klient i huaj iu drejtua një profesionisti ligjor për të blerë dy prona, një në Alpes-Maritimes (Jug të Francës) dhe tjetra në Paris, për 11 milionë euro.

Çmimi i blerjes u financua plotësisht nga blerësi (nuk kishte hipotekë) dhe fondet u dërguan përmes një banke në një juridiksion offshore.

Ndërsa kontrata ishte gati për t'u nënshkruar, pati një ndryshim në udhëzime dhe si blerës u zëvendësua një kompani investimi në pronë. Dy fëmijët e mitur të klientit ishin aksionarë të shoqërisë.

Klienti i huaj mbante një funksion të rëndësishëm politik në vendin e tij dhe kishte informacion të disponueshëm publikisht për përfshirjen e tij në keqbërje financiare.

#### **Rasti 3**

#### **Treguesit e flamurit të kuq:**

- Profesionisti ligjor ndodhej në një distancë nga klienti/transaksioni dhe nuk kishte asnjë arsye legjitime apo ekonomike për përdorimin e këtij profesionisti ligjor ndaj atij që ndodhej më afër.
- Shuma disproporcionale e financimit privat që është në kundërshtim me profilin socio-ekonomik të individit
- Klienti po përdor llogari bankare nga një vend me rrezik të lartë
- Ka ndryshime të pashpjegueshme në udhëzime, veçanërisht në minutën e fundit
- Transaksioni është i pazakontë sa i përket mënyrës së ekzekutimit të tij - në Francë është krejt e pazakontë që prona rezidenciale të blihet përmes një subjekti korporativ ose që të miturit të jenë aksionarë.
- Përdorimi i një strukture të ndërlikuar pa arsye legjitime
- Aksionarët e palës ekzekutive janë nën moshën madhore
- Klienti mban një pozicion publik dhe është i angazhuar në biznes të pazakontë privat duke pasur parasysh karakteristikat e përfshira.

#### **Rasti 4: Profesionistët ligjorë ndihmojnë me hapjen e llogarive bankare dhe investimin në prona nëpërmjet strukturave komplekse të korporatës**

Një i huaj me banim në Belgjikë u prezantua në një bankë nga një firmë ligjore me qëllim që të hapte një llogari. Kjo llogari kreditohej me shuma të mëdha nga transfere të huaja të porositura nga një homolog i panjohur. Një noter i së drejtës civile shkroi çeqe me porosi bankare nga llogaria, e cila më pas u investua në projekte të pasurive të paluajtshme në Belgjikë. Në një nga këto projekte, personi i dyshuar u ndihmua nga investitorë të tjerë të huaj për të krijuar një skemë veçanërisht të ndërlikuar.

Nga marrja në pyetje e noterit të së drejtës civile, NjIF-i mësoi se ai ishte angazhuar nga katër kompani të huaja për të ndihmuar në ngritjen e dy kompanive mbajtëse. Këto dy kompani kishin krijuar nga ana e tyre dy kompani të tjera Belge të pasurive të paluajtshme. Dhe këto dy të fundit kishin investuar më pas në pasuri të paluajtshme.

Personat që përfaqësonin këto kompani – një avokat dhe tregtar i diamanteve – vepronin si ndërmjetës për personin e dyshuar. Mësohet se avokati që ia kishte prezantuar bankës këtë person ishte i përfshirë edhe në skema të tjera të natyrës së ngjashme. Adresa e zyrës së regjistruar të kompanive belge ishte edhe adresa e zyrës së avokatit të tij.

Ky informacion tregoi rolin e rëndësishëm që luante avokati në ngritjen e një strukture financiare dhe korporative të krijuar për të mundësuar investimin e fondeve nga menaxher të huaj të panjohur për t'u investuar në projekte të pasurive të paluajtshme në Belgjikë. Bazuar në të gjitha elementet, NjIF-i vendosi të raportojë dosjen për pastrimin e produkteve të kimit të organizuar.

<p><b>Rasti 4</b></p> <p><b>Treguesit e flamujve të kuq:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i strukturave të ndërlikuara të pronësisë ku nuk ka asnjë arsye legjitime ose ekonomike.</li> <li>• Klienti po përdor një agjent ose ndërmjetës pa qëllim të mirë.</li> <li>• Përfshirja e strukturave me shumë vende ku nuk ka asnjë lidhje të dukshme me klientin ose transaksionin, ose asnjë arsye tjetër legjitime ose ekonomike.</li> <li>• Burimi i fondeve është i pazakontë, pasi ka financim nga palët e treta pa lidhje të dukshme apo shpjegim legjitim dhe fondet merren nga një vend i huaj ku nuk ka lidhje të dukshme midis vendit dhe klientit.</li> </ul>
--	--

### **Rasti 5: Profesionisti ligjor krijon struktura të shumta kompanish ndërkombëtare për klientët ekzistues**

Një profesionisti ligjor në Spanjë iu kërkua të krijonte një sërë kompanish për klientët me qëllim blerjen e pasurive të patundshme.

Disa kompani u themeluan në Spanjë, por ato ishin në pronësi të kompanive të cilat profesionisti ligjor i inkorporoi gjithashtu në një shtet amerikan.

Profesionisti ligjor dhe të tjerët në firmën ligjore do të përbënin bordin e drejtorëve të kompanive të inkorporuara në Amerikë. Ata më vonë do t'ua shisnin këto kompani klientëve të tyre.

Profesionisti ligjor krijoi mbi 300 kompani të tilla për klientët e firmës ligjore dhe vazhdoi t'i administronte këto të fundit për ta.

Shumë nga klientët dihej se ishin të përfshirë në organizata kriminale ndërkombëtare.

#### **Rasti 5**

#### **Treguesit e flamujve të kuq:**

- Përfshirja e strukturave me shumë vende ku nuk ka asnjë lidhje të dukshme me klientin ose transaksionin ose asnjë arsye tjetër legjitime ose ekonomike.
- Përfshirja e vendeve me rrezik të lartë.
- Klienti dihet se ka dënime për përfitime nga krimi, që aktualisht është nën hetim për përfitime nga krimi ose ka lidhje të njohura me kriminelë.

### **Rasti 6: Profesionistë ligjorë që veprojnë si aksionarë të emëruar të pazbuluar në kompani të dyshuara si subjekte për krimin e organizuar**

Një avokat u raportua nga një institucion bankar Italian në lidhje me disa transaksione bankare të kryera për llogari të kompanive që operonin në sektorin e energjisë së erës, në të cilin ai kishte një aksion. Subjektet raportuese dyshuan se aksionet mbaheshin në fakt në emër të disa klientëve të tij dhe jo për vete.

Raporti kishte të bënte me një kompani në pronësi të avokatit, i cili ia shiti një pakicë të aksioneve të tij (të fituar dy vjet më parë për një çmim shumë më të ulët) një kompanie tjetër të autorizuar për të ndërtuar një fermë me erë. Shumica e aksioneve i përkiste një firme në pronësi të një avokati tjetër të specializuar në sektorin e energjisë së ripërtërishme dhe të përfshirë në disa hetime nga zbatuesit e ligjit në lidhje me infiltrimin e organizatave të organizuara kriminale në këtë sektor.

E gjithë kompania ishte blerë nga një korporatë e madhe që vepron në sektorin e energjisë. Flukset financiare treguan se firma mëmë e kompanisë që po shitet ka marrë 59 milionë € nga

korporata. Megjithëse shumica e fondeve u përdorën ose me këste për të shlyer linjat e financimit të marra më parë nga huadhënësit italianë dhe të huaj ose u transferuan në kompani të tjera që i përkasin të njëjtit grup financiar, ku disa fonde u kredituan në llogarinë e mbajtur në emër të firmës ligjore, partner i së cilës ishte avokati i raportuar. Janë vërejtur edhe transferime të profesionistëve të tjerë ligjorë.

<p><b>Rasti 6</b></p> <p><b>Treguesit e flamujve të kuq:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ka përpjekje për të fshehur pronarin ose palët e vërteta në transaksion.</li> <li>• Klienti dihet se ka lidhje me kriminelë.</li> <li>• Letrave me vlerë të transferuara i kushtohet një çmim tepër i lartë, në lidhje me rrethanat që tregojnë një tejkalim të tillë ose në lidhje me shumën e deklaruar në një operacion tjetër.</li> </ul>
--	--

## 6 FINANCIMI I TERRORIZMIT DHE FINANCIMI I PËRHAPJES

### 6.1 Përkufizimi i financimit të terrorizmit

**Terrorizmi**, në kuptimin e tij më të gjerë, nënkupton çdo përdorim të dhunës për qëllime të arritjes së qëllimeve politike. Dhuna është mjet detyrimi mbi subjekte të caktuara (shtetërore, organizata ndërkombëtare, institucione fetare, politike, kushtetuese, ekonomike apo sociale etj.) për të bërë ose për të mos bërë diçka. Ka objektiva të ndryshëm themelorë të terrorizmit. Ato përfshijnë arritjen e objektivave politike, etnike dhe fetare.

Intensiteti i aktiviteteve terroriste ndërkombëtare varet nga fondet që mund të mbledhin terroristët, ndaj është jashtëzakonisht e rëndësishme që të zbulohet dhe pamundësohet në kohën e duhur çdo përpjekje për financimin e aktiviteteve terroriste.

### 6.2 Metodat e përdorura për financimin e terrorizmit

Ekzistojnë dy metoda kryesore të financimit të aktiviteteve terroriste. Metoda e parë përfshin mbledhjen e ndihmës financiare nga vende, organizata ose individë, ndërsa e dyta përfshin aktivitete që sjellin fitim, por që mund të jenë të ligjshme dhe të paligjshme.

#### a. Mbledhja e ndihmës financiare

Anëtarët e grupeve terroriste mund të financohen për veprimtarinë e tyre terroriste nga qeveria e një vendi ose nga organizatat. Mbështetja e një vendi mund të zëvendësohet gjithashtu nga një mbështetje nga burime të tjera si individët që zotërojnë fonde të konsiderueshme financiare ose fonde të grumbulluara nga donatorë që nuk dyshojnë për organizatat jofitimprurëse.

#### b. Aktivitetet që gjenerojnë të ardhura nga krimi

Burimet e financimit të terrorizmit mund të jenë të ligjshme ose të paligjshme, mund të vijnë nga aktivitete kriminale si mashtrimi, tregtia e drogës ose rrëmbimi, por ato gjithashtu mund të vijnë nga burime të ligjshme si huat, tarifatat e anëtarësimit, shitja e botimeve, donacionet etj. Rrëmbimet dhe zhvatjet kanë një synim të dyfishtë, të mbështesin financiarisht një

organizatë terroriste, duke përhapur në të njëjtën kohë shqetësim dhe frikë në një popullatë të synuar ose një grup njerëzish.

### 6.3 Lidhja ndërmjet pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Metodat e përdorura nga grupet terroriste për gjenerimin/mbledhjen e fondeve financiare nga burime të paligjshme janë të ngjashme me metodat e përdorura nga organizata të tjera kriminale. Ashtu si grupet e tjera kriminale, edhe ato duhet të gjejnë mënyrën e pastrimit të fondeve të paligjshme në mënyrë që të mund t'i përdorin ato pa tërhequr vëmendjen e autoriteteve kompetente.

Burimet e financimit të terrorizmit mund të jenë të ligjshme ose të paligjshme, mund të vijnë nga aktivitete kriminale si mashtrimi, tregtia e drogës ose rrëmbimi, por ato gjithashtu mund të vijnë nga burime të ligjshme si huat, tarifat e anëtarësimit, shitja e botimeve, donacionet etj. Financimi i terrorizmit nuk përfshin gjithmonë shuma të mëdha parash; transaksionet nuk duhet domosdoshmërisht të jenë të ndërlikuara siç është rasti me pastrimin e parave. Megjithatë, metodat e përdorura nga organizatat terroriste për transferimin, mbledhjen dhe fshehjen e burimeve të financimit mbeten të ngjashme me ato të përdorura nga organizatat kriminale për qëllime të pastrimit të parave. Prandaj, një regjim gjithëpërfshirës dhe efektiv i parandalimit të pastrimit të parave është çelësi për monitorimin e aktiviteteve financiare të grupeve terroriste.

### 6.4 Përkufizimi i financimit të përhapjes

**Përhapja** –përkufizohet si “prodhim, blerje, posedim, zhvillim, eksport, ngarkim, ndërmjetësim, transport, transferim, grumbullim, furnizim, shitje ose përdorim të armëve bërthamore, balistike, kimike, radiologjike ose biologjike ose çdo armë tjetër që mund të shkaktojë shkatërrim në masë dhe mjetet e shpërndarjes së tyre, të shpërndarjes dhe materialeve përkatëse, duke përfshirë teknologjitë dhe mallrat me përdorim të dyfishtë të përdorura për qëllime jo legjitime, përfshirë teknologjinë, mallrat, softuerin, shërbimet ose ekspertizën, në kundërshtim me këtë përkufizim ose, aty ku është e zbatueshme, detyrimi ndërkombëtar që rrjedh nga rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit dhe “aktiviteti i përhapjes” do të interpretohen në përputhje me rrethanat”.

**Financimi i përhapjes** – është ofrimi me dashje ose pakujdesi i fondeve ose shërbimeve financiare për t'u përdorur për përhapjen, p.sh. prodhimin, blerjen, posedimin, zhvillimin, eksportin, ngarkimin, ndërmjetësimin, transportin, transferimin, grumbullimin, furnizimin, shitjen ose përdorimin e armëve bërthamore, balistike, kimike, radiologjike ose biologjike ose çdo armë tjetër e aftë për të shkaktuar përhapjen e shkatërrimit në masë dhe mjetet e tyre të shpërndarjes.

## 7 MASAT KYÇE QË DUHEN MARRË NGA SUBJEKTET RAPORTUESE PËR ZBATIMIN E DETYRIMEVE TË LIGJIT PPP/LFT

Një regjim efektiv i parandalimit dhe zbulimit të PP/FT-së është ai ku subjektet raportuese:

- Përbushin plotësisht detyrimet e tyre të ligjshme;
- Kanë përshtatur operacionet e tyre të biznesit për të luftuar rrezikun e PP/FT-së;
- Masat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit zbatohen në mënyrë të vazhdueshme; dhe
- Përbushin standardet ekzistuese ndërkombëtare dhe kombëtare kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Në mënyrë që subjektet raportuese të kuptojnë më mirë dhe të arrijnë përbushjen e detyrimeve të tyre sipas Ligjit LPP/LFT, në këtë udhëzues janë grupuar pesë (5) kategori kyçe të masave. Këto kategori janë si më poshtë:

- Qasja e bazuar në rrezik dhe kontrollet e brendshme;
- Kujdesi i duhur ndaj klientit;
- Monitorimi dhe raportimi i vazhdueshëm;
- Mbajtja e të dhënave dhe mbajtja e shënimeve; dhe
- Monitorimi i financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes.

Udhëzime të hollësishme jepen në secilën prej këtyre kategorive për kërkesat që duhet të plotësojnë subjektet raportuese.

### 7.1 Qasja e bazuar në rrezik dhe kontrollet e brendshme

#### QASJA E BAZUAR NË RREZIK


Subjekteve raportuese u kërkohet të bëjnë një vlerësim dhe të dokumentojnë rreziqet që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Qasja e bazuar në rrezik është një proces që lejon subjektet raportuese të identifikojnë rreziqet e mundshme të larta të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe të zhvillojnë strategji për t'i zbutur ato. Kur bëhet fjalë për situata ku kujdesi i duhur i shtuar është i përshtatshëm, një parim i qasjes së bazuar në rrezik do t'i lejojë subjektet raportuese të përqendrojnë burimet aty ku janë më të nevojshme për të menaxhuar rreziqet brenda nivelit të tolerancës së subjektit raportues.

Qasja ndaj menaxhimit dhe zbutjes së rrezikut kërkon udhëheqjen dhe angazhimin e menaxhmentit të lartë drejt zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Menaxhmenti i lartë është në fund të fundit përgjegjës për marrjen e vendimeve të menaxhimit në lidhje me rregulloret, procedurat dhe proceset që zbusin dhe kontrollojnë rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit brenda një biznesi.

Shtrirja e masave të aplikuara për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duhet të jetë proporcionale me shkallën e identifikuar të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (qasja e bazuar në rrezik).

Ekzistojnë tre hapa për të krijuar një qasje të bazuar në rrezik: vlerësimi, zbutja dhe monitorimi i rrezikut. Diagrami i mëposhtëm përshkruan vizualisht tre hapat e ndryshëm në zbatimin e qasjes të bazuar në rrezik.

**Diagrami 1: Qasja e bazuar rrezik**



### 7.1.1 Vlerësimi i rrezikut

Vlerësimi i rrezikut është një analizë e kërcënimeve dhe cenueshmërive të mundshme ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ndaj të cilave është i ekspozuar biznesi i subjektit raportues. Ndërlikueshmëria e vlerësimit varet nga madhësia dhe faktori i rrezikut të biznesit të subjekteve.

Vlerësimi i rrezikut i kryer nga profesionistët ligjorë duhet të marrë parasysh rezultatet e Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar (VRrK-së) të kryer nga Kosova. VRrK-ja përcaktoi se noterët kishin një cenueshmëri të lartë ndaj PP/FT-së për shkak të përfshirjes së tyre në kryerjen e transaksioneve të pasurive të paluajtshme.<sup>5</sup> Avokatët u konsideruan se kishin një cenueshmëri të ulët ndaj PP/FT-së.<sup>6</sup>

<sup>5</sup> Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut në Kosovë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, gusht 2020, f.51

<sup>6</sup> Po aty f. 53.



Gjatë kryerjes së vlerësimit të rrezikut, subjektet raportuese duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë rreziqet kryesore të PP/FT-së në kategoritë e mëposhtme:

- Klientët;
- Produktet, shërbimet dhe transaksionet;
- Praktikrat e biznesit/kanalet e përhapjes; dhe
- Rrezikun gjeografik.

#### ➤ **Rreziku i klientit**

Subjektet raportuese duhet të marrin në konsideratë natyrën dhe biznesin e klientëve të tyre për të përcaktuar nivelin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Me fjalë të tjera, subjektet raportuese duhet të njohin klientët e tyre për të kryer një vlerësim të rrezikut. Njohja e klientëve nuk kufizohet në identifikimin ose kërkesat e mbajtjes së të dhënave. Bëhet fjalë për të kuptuarit e klientëve, duke përfshirë aktivitetet e tyre, modelet e transaksioneve, mënyrën se si ata veprojnë e kështu me radhë. Elementë të tjerë, të tillë si madhësia e aktiveve të një klienti ose numri i transaksioneve të përfshira, mund të jenë gjithashtu të rëndësishëm.

Disa subjekte raportuese mund të zgjedhin të kryejnë vlerësim rreziku për secilin klient. Të tjerët, bazuar në natyrën e biznesit të tyre, mund të zgjedhin të grupojnë klientët sipas kategorive dhe të kryejnë një vlerësim rreziku për grupin e klientëve. Për shembull, një noter mund të zgjedhë të identifikojë çdo klient që ndodhet jashtë Kosovës si rrezik më të lartë. Nuk kërkohet një vlerësim individual i secilit klient.

VRRK-ja në Kosovë tregoi se klientët e mëposhtëm konsideroheshin me rrezik më të lartë për profesionistët ligjorë:

- Klientët me vlerë të lartë neto;
- Personat e ekspozuar politikisht;
- Bizneset intensive të parave të gatshme;
- Ndërtimi; dhe
- Pronat e paluajtshme.<sup>7</sup>

Shtojca 2 ofron shembuj shtesë të klientëve me rrezik më të lartë.

#### ➤ **Shërbimet dhe rreziku i transaksionit**

Subjektet raportuese duhet të jenë të vetëdijshme dhe të njohin produktet dhe shërbimet ose kombinimet e tyre që mund të paraqesin rreziqe më të larta të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit. Produktet dhe shërbimet legjitime mund të përdoren për të fshehur origjinën e paligjshme të fondeve, për të lëvizur fonde për të financuar akte terroriste ose për

<sup>7</sup> Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar në Kosovë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, gusht 2020, f. 52.

të fshehur identitetin e vërtetë të pronarit ose përfituesit aktual të produktit ose shërbimit. Produktet dhe shërbimet që mund të mbështesin lëvizjen dhe shndërrimin e aseteve në, përmes dhe jashtë sistemit financiar mund të përbëjnë një rrezik të lartë. Përveç kësaj, ju mund të konsideroni gjithashtu shërbimet e identifikuar nga rregullatorët, autoritetet qeveritare ose burime të tjera të besueshme si potencialisht me rrezik të lartë për pastrim parash ose financim terrorizmi.

VRrK-ja në Kosovë tregoi se produktet e mëposhtme konsideroheshin me rrezik më të lartë për profesionistët ligjorë:

- Menaxhimi i pasurive dhe llogarive financiare të klientëve;
- Ndihma në blerjen dhe shitjen e tokës ose subjekteve afariste, dhe
- Blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme.<sup>8</sup>

Shtojca 2 jep shembuj shtesë për rrezikun më të lartë të shërbimit dhe transaksionit për profesionistët ligjorë.

#### ➤ **Rreziku i praktikave të biznesit/kanaleve të përhapjes**

Subjekteve raportuese u kërkohet gjithashtu të marrin në konsideratë kanalet e përdorura për të ofruar produktet ose shërbimet e tyre. Në ekonominë e sotme dhe tregun global, shumë kanale të përhapjes nuk e sjellin klientin në kontakt të drejtpërdrejtë apo ballë për ballë me subjektin raportues (për shembull, internetin, telefonin ose postën), dhe janë të qasshme 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, pothuajse nga kudo. Largësia e disa prej këtyre kanaleve të përhapjes mund të përdoret gjithashtu për të errësuar identitetin e vërtetë të një klienti ose pronarësh përfitues dhe për këtë arsye mund të paraqesë rreziqe më të larta.

#### ➤ **Rreziku gjeografik**

Subjektet raportuese duhet të marrin në konsideratë nëse vendndodhjet gjeografike në të cilat ato operojnë ose ndërmarrin aktivitete paraqesin një rrezik potencialisht më të lartë për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Në varësi të biznesit dhe operacioneve të tyre, vendndodhjet gjeografike mund të variojnë nga rrethinat e tyre të afërta, qofshin ato rurale apo urbane apo vende të tjera.

Një listë kontrolli në Shtojcën 3 jep një shembull, për përdorim nga subjektet raportuese, për të lehtësuar vlerësimin e faktorëve të mësipërm. Megjithatë, vlerësimi i rrezikut të një subjekti raportues duhet të jetë i përshtatshëm për nevojat e tyre specifike të biznesit që do të thotë se ai duhet të jetë më i detajuar se lista kontrolluese e dhënë. Subjektet raportuese mund të personalizojnë listën e kontrollit ose mund të përdorin një metodë ose një mjet tjetër.

---

<sup>8</sup> Po aty f.46 dhe f.52.

## ➔ Rreziku i lartë për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit

Megjithëse nuk ka një listë përgjithësisht të pranuar të kategorive të rrezikut, shembujt e listuar në Shtojcën 2 paraqesin shembuj të rrezikut më të lartë gjeografik. Këto rreziqe të mundshme mund t'ju ndihmojnë në përcaktimin e situatave me rrezik më të lartë. Duhet të theksohet se nëse përcaktoni se një klient ose situatë është me rrezik më të lartë, ju kërkohet të aplikoni masa për zbutjen e rrezikut dhe kujdes të duhur të shtuar. Nuk ju kërkohet të refuzoni transaksionin ose të përfundoni marrëdhënien e biznesit.

### Variablat që mund të kenë ndikim në rrezik

Subjektet raportuese duhet të marrin parasysh veçoritë, shkallën e rrezikut ose dyshimin e një transaksioni ose një marrëdhënie biznesi të rekomanduar. Prandaj, procedura e vlerësimit të rrezikut mund të përmbajë edhe rreziqe të ndryshueshme të cilat janë specifike për një klient të caktuar ose një lloj biznesi. Ekzistenca e një ose më shumë variablave mund të rezultojë në zbatimin e një kontrolli të duhur të shtuar dhe në nevojën për të monitoruar, ose në një kontroll dhe monitorim të zakonshëm i cili mund të reduktohet ose thjeshtohet. Variablat e mëposhtëm janë variabla që mund të kenë ndikim në rritjen ose uljen e rrezikut të klientit ose llojit të biznesit të caktuar:

- Natyra e një marrëdhënie biznesi me një klient dhe ekzistenca e aktiviteteve specifike;
- Niveli i legjislacionit apo ekzistimi i mbikëqyrjes nga organet kompetente. Për shembull, klientët që i nënshtrohen një sistemi të kënaqshëm të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit paraqesin një rrezik më të ulët se sa klientët nga industria ku ekziston rreziku i pastrimit të parave për shkak se nuk janë të gatshëm për të parandaluar këto aktivitete;
- Reputacioni dhe informacioni i disponueshëm publikisht mbi klientin. Personat juridikë të cilët janë transparentë dhe të njohur në domenin publik dhe që funksionojnë për shumë vite pa u dhënë vendime ndaj tyre (vepra që lidhen me pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme) paraqesin rrezik të ulët për pastrim parash;
- Rregullsia ose kohëzgjatja e një marrëdhënie biznesi;
- Njohuria për vendin e klientit, duke përfshirë njohjen e ligjeve, rregulloreve dhe rregullave vendore, si dhe strukturën dhe fushëveprimin e një mbikëqyrjeje rregullatore;
- Proporcionaliteti ndërmjet madhësisë ose fushëveprimit dhe jetëgjatësisë së të bërit biznes të klientit duke përfshirë natyrën e shërbimit të kërkuar;
- Distanca gjeografike e konsiderueshme ose e pashpjegueshme ndërmjet një avokati ose noteri dhe një klienti, kur nuk ka nevojë për këtë;
- Një person që mund të bëhet klient urdhëron një avokat ose një noter të kryejë vetëm një transaksion (më i rrezikshëm se një marrëdhënie e vazhdueshme këshillimi);
- Rreziqet që vijnë nga përdorimi i teknologjisë së re që mundëson një marrëdhënie biznesi pa praninë e klientit (jo ballë për ballë) dhe që favorizon anonimitetin;

- Kur klienti i ardhshëm rekomandohet nga një person konfidencial i cili është subjekt i regjimit LPP/LFT, dhe i cili është në përputhje me standardet e FATF, rekomandimi mund të konsiderohet si një faktor zbutës rreziku;
- Struktura e një klienti ose një transaksioni. Strukturat pa qëllime të dukshme ligjore, tatimore, biznesore, ekonomike ose legjislative të tjera mund të rrisin rrezikun.

Shtojca 3 jep një shembull të një liste kontrolli të vlerësimit të rrezikut që mund të përdoret nga subjektet raportuese.

### ➔ **Kriteret e vlerësimit – Vlerësimi i rrezikut**

Kur përcaktohet nëse një subjekt raportues ka zbatuar siç duhet masat e vlerësimit të rrezikut, kriteret e mëposhtme do të vlerësohen:

**Vlerësimi i rrezikut të PP/FT-së është dokumentuar** - Është e rëndësishme që vlerësimi i rrezikut i zhvilluar nga subjekti raportues të jetë i dokumentuar. Kjo lejon që rezultatet e vlerësimit të rrezikut të ndahen me menaxhmentin dhe punonjësit.

**Vlerësimi i rrezikut është në proporcion me madhësinë dhe kompleksitetin e biznesit** - Vëmendja e duhur duhet t'i kushtohet dallimeve të mëdha dhe të thella në praktika, madhësi, shkallë dhe ekspertizë, midis subjekteve raportuese. Si rezultat, duhet t'i kushtohet vëmendje këtyre faktorëve kur vlerësohet vlerësimi i rrezikut dhe strategjitë e zbutjes së një subjekti raportues.

Vlerësimi i rrezikut mund të marrë forma të ndryshme në varësi të madhësisë dhe operacioneve të subjektit raportues. Një listë kontrolli mund të jetë e përshtatshme për një subjekt të vogël, mirëpo një dokument më gjithëpërfshirës që përfshin një matricë rreziku mund të jetë i përshtatshëm për subjekte më të mëdha.

**Vlerësimi i rrezikut duhet të marrë parasysh elementët kryesorë të rrezikut** - Vlerësimi i rrezikut të një subjekti raportues duhet të përbëhet, së paku, nga elementët e mëposhtëm:

- **Rreziku i klientit** - Subjekti raportues duhet të marrë në konsideratë natyrën dhe biznesin e klientit të tij, marrëdhëniet e tyre të biznesit për të përcaktuar nivelin e rrezikut të PP/FT-së lidhur me çdo lloj klienti ose marrëdhënie biznesi. Duhet të theksohet se kryerja e një vlerësimi të rrezikut për çdo klient individual nuk kërkohet.
- **Produkti/shërbimet** - Një vlerësim i përgjithshëm i rrezikut duhet të përfshijë përcaktimin e rreziqeve të mundshme që lidhen me shërbimet e ofruara nga subjekti raportues, duke vënë në dukje se subjekte të ndryshme raportuese ofrojnë një gamë të gjerë dhe të larmishme shërbimesh. Konteksti i shërbimeve që ofrohen është gjithmonë thelbësor për një qasje të bazuar në rrezik.
- **Praktikat e biznesit/kanalet e përhapjes** – Subjekti raportues duhet të marrë parasysh kanalet e përdorura për të ofruar produktet dhe shërbimet e tyre. Shumë

kanale të përhapjes nuk e sjellin subjektin raportues në kontakt të drejtpërdrejtë apo ballë për ballë me klientin. Vëmendje duhet t'i kushtohet largësisë së kanaleve të përhapjes, pasi ato mund të përdoren gjithashtu për të errësuar identitetin e vërtetë të një klienti ose pronarësh përfitues dhe për këtë arsye mund të paraqesin rreziqe më të larta.

- **Rreziku gjeografik** - Subjekti raportues duhet të marrë parasysh nëse vëndndodhjet gjeografike në të cilat ai operon, dhe ndërmerr aktivitete ku ndodhen klienti ose fondet paraqesin rrezik potencialisht më të lartë për PP/FT.

**Strategjitë e vlerësimit të rrezikut rishikohen nga menaxhmenti i lartë** – Udhëheqja e fortë e menaxhmentit të lartë dhe angazhimi në LPP/LFT është një aspekt i rëndësishëm i aplikimit të qasjes së bazuar në rrezik. Menaxhmenti i lartë duhet të miratojë strategjitë e vlerësimit të rrezikut dhe të sigurojë që ato të rishikohen të paktën një herë në dy vjet duke marrë parasysh ndryshimet si hyrja e institucionit në tregje të reja dhe futja e produkteve dhe shërbimeve të reja.

**Një vlerësim rreziku kryhet për produkte të reja, praktikë biznesi ose teknologji.** Vlerësimi i rrezikut duhet të kryhet përpara prezantimit të produktit të ri, praktikës së re të biznesit ose teknologjisë së re, si të produkteve të reja, ashtu edhe atyre ekzistuese. Vlerësimi dokumentohet dhe i vihet në dispozicion NjIF-it ose autoritetit mbikëqyrës sipas kërkesës.

**Strategjitë e vlerësimit të rrezikut ndahen me punonjësit** - Që një kornizë e menaxhimit të rrezikut të jetë efektive, punonjësit duhet të jenë të vetëdijshëm për ato situata që janë identifikuar si me rrezik më të lartë

### 7.1.2 Zbutja e rrezikut

Zbutja e rrezikut ka të bëjë me zbatimin e masave për të kufizuar rreziqet e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që subjekti raportues ka identifikuar duke qëndruar brenda nivelit të tij të tolerancës ndaj rrezikut. Si pjesë e kontroleve të tij të brendshme, kur vlerësimi i rrezikut përcakton se rreziqet janë të larta për PP-në ose FT-në, subjekti raportues duhet të zhvillojë strategji të shkruara për zbutjen e rrezikut (rregullore dhe procedura të dizajnuara për të zbutur rrezikun e lartë) dhe t'i zbatojë ato për situata me rrezik të lartë. Shtojca 4 ofron një listë të masave për zbutjen e rrezikut që mund të jenë të përshtatshme për situatat që ju keni përcaktuar si rrezik më të lartë.

### ➡️ **Kriteret e vlerësimit – Zbutja e rrezikut**

Kur përcaktohet nëse një subjekt raportues ka zbatuar në mënyrë të duhur masa për zbutjen e rrezikut, do të vlerësohen kriteret e mëposhtme:

**Strategjitë e zbutjes së rrezikut janë të dokumentuara** - Është e rëndësishme që strategjitë e zbutjes së rrezikut të zhvilluara nga subjekti raportues të dokumentohen. Kjo lejon që strategjitë e zbutjes së rrezikut të ndahen me menaxhmentin dhe punonjësit.

**Janë zbatuar strategjitë për zbutjen e rrezikut.** Zbatimi i strategjive zbutëse duhet të regjistrohet për të demonstruar se janë zbatuar masat zbutëse.

**Strategjitë e zbutjes së rrezikut rishikohen nga menaxhmenti i lartë çdo dy vjet** – Udhëheqja e fortë e menaxhmentit të lartë dhe angazhimi në LPP/LFT është një aspekt i rëndësishëm i aplikimit të qasjes së bazuar në rrezik. Menaxhmenti i lartë duhet të miratojë strategjitë e zbutjes së rrezikut dhe të sigurojë që ato të rishikohen të paktën çdo dy vjet.

**Strategjitë e zbutjes së rrezikut ndahen me punonjësit** - Kjo do t'i lejojë punonjësit të zbatojnë masat për zbutjen e rrezikut të vendosura nga menaxhmenti i lartë.

### 7.1.3 Monitorimi i rrezikut

Përveç vlerësimit të rrezikut dhe aktiviteteve për zbutjen e rrezikut, Ligji PPP/LFT gjithashtu kërkon që subjektet raportuese të marrin masa për të kryer monitorimin e vazhdueshëm të transaksioneve financiare. Niveli i monitorimit duhet të përshtatet sipas rreziqeve të PP/FT-së, siç përshkruhet në vlerësimin e rrezikut të subjektit raportues. Qëllimi i aktiviteteve të vazhdueshme të monitorimit është të ndihmojë në zbulimin e transaksioneve të dyshimta.

Politikat, kontrollet dhe procedurat e subjektit raportues duhet të përcaktojnë se çfarë lloj monitorimi bëhet për situata të veçanta me rrezik të lartë, duke përfshirë mënyrën e zbulimit të transaksioneve të dyshimta. Politikat, kontrollet dhe procedurat duhet gjithashtu të përshkruajnë se kur bëhet monitorimi (frekuenca e tij), si rishikohet dhe si do të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme. Seksioni 6.1 i këtij udhëzuesi sqaron gjithashtu obligimet tjera monitoruese dhe mënyrën se si mund të kryhen aktivitetet monitoruese.

Subjektet raportuese mund të përdorin monitorim manual ose automatik në varësi të madhësisë dhe ndërlikueshmërisë së operacioneve të tyre. Për subjektet më të mëdha raportuese, monitorimi manual mund të mos jetë i përshtatshëm në varësi të shpeshtësisë dhe madhësisë së transaksioneve.

#### ➔ Kriteret e vlerësimit – Monitorimi i rrezikut

Kur përcaktohet nëse një subjekt raportues ka zbatuar në mënyrë adekuate masat e monitorimit të rrezikut, do të vlerësohen kriteret e mëposhtme:

**Është zhvilluar një orar monitorimi** - Subjektet raportuese duhet të rishikojnë transaksionet bazuar në një orar të miratuar që përfshin nënshkrimin e menaxhmentit.

**Ndryshimet në aktivitete janë të dokumentuara** - Subjekti raportues duhet të shënojë ndryshime në aktivitete që janë në kundërshtim me modelet normale të transaksioneve ose aktivitetet e klientit. Ekziston një proces për të ngritur shqetësimet sipas nevojës.

**Janë vendosur parametrat e monitorimit** - Subjektet raportuese duhet të përcaktojnë kufijtë ose parametrat e biznesit në lidhje me transaksionet që do të shkaktonin sinjale paralajmëruese të hershme dhe do të kërkonin rishikim të detyrueshëm. Dokumentet operative demonstrojnë se rregullorja zbatohet në mënyrë efektive.

**Transaksionet ose marrëdhëniet me rrezik të lartë monitorohen më shpesh** - Subjektet raportuese shqyrtojnë më shpesh transaksionet me rrezik të lartë kundrejt treguesve të transaksioneve të dyshimta që lidhen me marrëdhënien dhe i përshkallëzojnë ato nëse zbulohen tregues shtesë.

**Aktivitetet e monitorimit marrin parasysh qëllimin e marrëdhënieve të biznesit dhe burimin e synuar të fondeve** - Gjatë kryerjes së monitorimit të vazhdueshëm, subjekti raportues duhet t'i referohet qëllimit të marrëdhënies së biznesit dhe burimit të synuar të fondeve që është dokumentuar në fillim të marrëdhënies së biznesit për të siguruar që aktivitetet korrespondojnë me atë që është deklaruar nga klienti.

**Transaksionet e dyshimta raportohen në NjIF** - Qëllimi i aktiviteteve të vazhdueshme të monitorimit është identifikimi i transaksioneve të dyshimta. Transaksionet që identifikohen nga subjektet si të dyshimta gjatë aktiviteteve të monitorimit duhet të raportohen në NjIF. Megjithëse një analizë rreptësisht sasiore e numrit të RTD-ve të raportuara nuk do të ishte e përshtatshme, duke pasur parasysh nivelet e ndryshme të rrezikut të PP/FT-së në secilin sektor të subjektit raportues, numri i transaksioneve të dyshimta të zbuluara mund të jetë potencialisht një tregues i një programi monitorues efektiv.

## 7.2 Politikat dhe procedurat për parandalimin e PP/FT/FP

Sipas nenit 17 (2) të Ligjit PPP/LFT, të gjitha subjektet raportuese duhet të nxjerrin politika dhe procedura të brendshme të shkruara, të vendosin kontrole për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe t'i zbatojnë ato. Këto politika, procedura dhe kontrole përfshijnë, por nuk duhet kufizuar në:

- Procedurën për kujdesin e duhur ndaj klientit, përfshirë procedurën për identifikimin dhe verifikimin e klientit;
- Procedurën e raportimit sipas nenit 26 të këtij ligji dhe dërgimit të informacionit, të dhëna, dhe dokumentacionin në NjIF-K;
- Procedurën për përpunimin ose marrjen e veprimeve të mëtejme lidhur me aktin apo transaksionin e dyshuar, duke përfshirë masat për ndalimin e veprimeve të mëtejme lidhur me aktin ose transaksionin e dyshuar në pajtim me paragrafin 5. të nenit 26 të këtij ligji;
- Emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë për të zbatuar detyrimet e përcaktuara në këtë ligj si dhe sigurimin e kushteve për punën e tyre;
- Sigurimin e organizimit dhe financimit të programit për trajnimin dhe aftësimin e të punësuarve mbi përgjegjësitë e parapara me këtë ligj;

- Krijimin e organeve adekuate të kontrollit të rregullt të brendshëm për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe funksionin e auditimit për të testuar sistemin e raportimit dhe identifikimit, përveç për subjektet me numër të kufizuar të stafit;
- Përfshirjen e listës së indikatorëve të hartuar nga NJiF-i dhe plotësimin e asaj liste me indikatorë sipas fushëveprimit të subjektit raportues, për identifikimin e personave dhe transaksioneve në lidhje me të cilat ka arsye për të dyshuar për pastrim të parave ose financim të terrorizmit;
- Procedurën për grumbullimin, mbajtjen, mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave në pajtim me këtë ligj dhe procedurën për parandalimin e qasjes së paautorizuar;
- Zbatimin e veprimeve dhe masave të tjera në bazë të këtij ligji.

### **7.2.1 Kriteret e vlerësimit-politikat dhe procedurat për parandalimin e PP/FT/FP**

**Politikat dhe procedurat për parandalimin e PP/FT/FP janë të dokumentuara** – Rregulloret dhe procedurat e programit duhet të dokumentohen.

**Politikat dhe procedurat për parandalimin e PP/FT/FP adresojnë të gjitha masat e përcaktuara** – Politikat dhe procedurat duhet të ofrojnë një pasqyrë të plotë se si subjekti raportues duhet të përmbushë detyrimet e LPP/LFT-së. Të gjitha kontrollet e brendshme duhet të përfshijnë masat e renditura në seksionin 4.2 të këtij udhëzuesi.

**Politikat dhe procedurat për parandalimin e PP/FT/FP zbatohen** – Subjektet raportuese duhet të sigurojnë që stafi të zbatojë, në rrjedhën e zakonshme të biznesit, të gjitha masat dhe veprimet e përshkruara në programin për parandalimin e PP/FT/FP.

**Profesionistët dhe punonjësit ligjorë kanë njohuri për politikat dhe procedurat** – Që rregulloret dhe procedurat të jenë efektive, profesionistët dhe punonjësit ligjorë duhet të kenë njohuri për rregulloret dhe procedurat e përshkruara në program dhe se si ato ndikojnë në aktivitetet e tyre të përditshme.

**Transaksionet e dyshimta identifikohen dhe raportohen** – Politikat dhe procedurat e subjektit raportues janë efektive në identifikimin dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta.

**Trajnimi është ofruar** -Punonjësit e subjektit raportues kanë marrë trajnime dhe kanë njohuri në lidhje me politikat dhe procedurat, trendet dhe tipologjitë e PP/FT-së dhe rreziqet që ekzistojnë brenda subjektit raportues.

**Politikat dhe procedurat për parandalimin e PP/FT/FP janë proporcionale** – Programi duhet të përshatet me praktikën, madhësinë, shkallën dhe ekspertizën e subjektit raportues.

**Ekzistojnë procedura dhe mekanizma për monitorimin e zbatimit të kontrolleve dhe përmirësimin e tyre, aty ku është e nevojshme.** Monitorimi duhet të sigurojë që politikat



dhe procedurat të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme si dhe adresimin e shkeljeve të rregulloreve dhe procedurave.

### 7.3 Emërimi i një zyrtari të pajtueshmërisë

Në bazë të nenit 21 (1) të Ligjit LPP/LFT, subjektet raportuese duhet të emërojnë një zyrtar të pajtueshmërisë në nivel të lartë menaxherial që të jetë përgjegjës për zbatimin dhe pajtueshmërinë e vazhdueshme me Ligjin LPP/LFT nga ai subjekt raportues.

#### 7.3.1 Kriteret e vlerësimit - zyrtari i pajtueshmërisë

**Emërohet një zyrtar i pajtueshmërisë** - Subjekti raportues ka emëruar zyrtarin e pajtueshmërisë, i cili është përgjegjës për kryerjen e masave dhe detyrave të LPP/LFT-së.

**Zyrtari i pajtueshmërisë ka autoritetin e nevojshëm për të zbatuar funksionet e tij.** Është e rëndësishme që zyrtari i pajtueshmërisë të ketë autoritetin e nevojshëm për të bërë ndryshime dhe për të ndikuar në vendimet që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe zbatimin e politikave të LPP/LFT-së. Për subjektet më të vogla kjo mund të nënkuptojë se pronari ose menaxheri i subjektit mban pozicionin e zyrtarit të pajtueshmërisë.

**Zyrtari i pajtueshmërisë ka linja të drejtpërdrejta komunikimi me menaxhmentin.** Është e rëndësishme që zyrtari i pajtueshmërisë të ketë linja të drejtpërdrejta komunikimi me menaxhmentin e lartë për të siguruar që çdo çështje me zbatimin e detyrimeve të LPP/LFT-së të komunikohet shpejt dhe me efikasitet.

**Zyrtari i pajtueshmërisë nuk ka precedentë penalë ose nuk është subjekt i procedimit penal.** Integriteti i zyrtarit të pajtueshmërisë është thelbësor duke kërkuar që të kryhet një kontroll i historisë kriminale.

**Zyrtari i pajtueshmërisë është i njohur me natyrën e operacioneve të subjekteve raportuese me të paktën 2 vjet përvojë.** Është e rëndësishme që personi i caktuar si zyrtar i pajtueshmërisë të kuptojë operacionet e subjektit raportues për të qenë në gjendje të zhvillojë kontrole të brendshme efektive që do të zbusin rreziqet e veçanta për atë institucion.

**Kushtet e mëposhtme i ofrohen zyrtarit të pajtueshmërisë për t'i lejuar ata të kryejnë siç duhet punën e tyre:** Subjektet raportuese i ofrojnë zyrtarit të pajtueshmërisë si në vijim:

- Qasje të pakufizuar në të dhëna, informacione dhe dokumentacion të nevojshëm për të kryer detyrat e tij;
- Resurse të nevojshme njerëzore, materiale të TI-së dhe burimet tjera të përshtatshme të punës;
- Hapësirë të duhur punuese dhe kushtet teknike për një nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave konfidenciale dhe të qasshme për zyrtar të pajtueshmërisë;
- Trajnim të vazhdueshëm profesional në fushë për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit;
- Zëvendësim gjatë mungesës;

- Mbrojtje në lidhje me zbulimin e të dhënave rreth zyrtarit të pajtueshmërisë tek persona të paautorizuar, si dhe mbrojtjen e procedurave të tjera të cilat mund të ndikojnë në kryerjen pa pengesë të detyrave dhe qasjes së paautorizuar në të dhëna;

**Zyrtari i pajtueshmërisë ka qasje të arsyeshme në informacionin që mund të jetë i rëndësishëm për të përcaktuar nëse ekziston një bazë e mjaftueshme për të raportuar një RTD.** Kjo duhet të përfshijë qasjen në të gjitha transaksionet e kryera nga subjekti raportues, si dhe çdo informacion të kërkuar për të përcaktuar nëse një transaksion është i dyshimtë.

**Aktiviteti i dyshimtë i raportohet zyrtarit të pajtueshmërisë** – I gjithë personeli në një subjekt raportues duhet të monitorojë dhe t'i raportojë zyrtarit të pajtueshmërisë çdo aktivitet të dyshimtë për PP/FT-në.

#### 7.4 Trajnimi

Të gjitha subjektet raportuese janë të detyruara, sipas nenit 17 (2.5) të Ligjit për LPP/LFT, të ofrojnë trajnime të vazhdueshme për zyrtarët dhe punonjësit për t'i informuar ata me ligjet që kanë të bëjnë me PP/FT/FP apo ndonjë vepër tjetër të ndërlidhur me PP/FT/FP, për t'i ndihmuar ata në njohjen e transaksioneve dhe veprimeve që mund të lidhen me PP/FT/FP ose ndonjë vepër tjetër të ndërlidhur me PP/FT/FP dhe t'i udhëzojë për procedurat që duhen ndjekur në ato raste.

Edukimi dhe trajnimi profesional mundëson njohjen me dispozitat e Ligjit për LPP/LFT dhe rregulloret për zbatimin e tij, standardet ndërkombëtare që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare për parandalimin e PP/FT/FP, udhëzuesit, listat e treguesve për njohjen e transaksioneve të dyshimta, raportimin dhe detyrimet për mbajtjen e shënimeve.

##### 7.4.1 Kriteret e vlerësimit-trajnimi

**Programi i trajnimit është dokumentuar** - Programi i trajnimit duhet të dokumentohet. Ai duhet të përshkruajë përmbajtjen e trajnimit, kur është mbajtur trajnimi dhe kush ka marrë pjesë në trajnim. Data e rishikimit të programit të trajnimit duhet gjithashtu të dokumentohet duke përfshirë çdo ndryshim që është bërë në programin e trajnimit.

**Programi i trajnimit është proporcional me madhësinë e biznesit** - Subjektet raportuese duhet të hartojnë, zhvillojnë, zbatojnë dhe përditësojnë programin e tyre të trajnimit si të përshtatshme për natyrën dhe madhësinë e biznesit të tyre. Trajnimi mund të kryhet përmes prezantimeve, dokumentacionit të shkruar ose përmes një programi trajnimi on-line.

**Programi i trajnimit është proporcional me nivelin e rrezikut të PP/FT** - Programi i trajnimit i subjekti raportues duhet gjithashtu t'i përshtatet rrezikut të PP/FT-së. Jo vetëm që do të thotë që përmbajtja e trajnimit duhet të fokusohet në dobësitë e veçanta që janë specifike për aktivitetet e biznesit, por gjithashtu që subjektet që janë në rrezik më të lartë për t'u përdorur për PP/FT duhet të ketë një program trajnimi më të përshtatur për rreziqet e identifikuara.

**Trajnimi është gjithëpërfshirës** - Përmbajtja e trajnimit duhet t'u sigurojë punonjësve dhe menaxhmentit të subjektit raportues një kuptim të qartë të përgjegjësive të tyre kundrejt detyrimeve LPP/LFT/FP dhe një pasqyrë të cënueshmërive që lidhen me operacionet e këtij biznesi. Në mënyrë të veçantë, programi i trajnimit duhet të përfshijë informacion mbi teknikat, metodat dhe tendencat e PP/FT/FP, një shpjegim të ligjeve dhe rregulloreve të LPP/LFT, një pasqyrë të kujdesit të duhur ndaj klientit, mbajtjen e të dhënave dhe kërkesat e raportimit, një rishikim të programit të njësisë për parandalimin e PP/FT/FP, vlerësimin e rrezikut dhe strategjitë për zbutjen e rrezikut.

**Trajnimi kryhet të paktën çdo vit** – Trajnimi duhet të kryhet të paktën çdo vit. Trajnimi duhet të kryhet më shpesh nëse ka ndryshime në praktikat e biznesit ose kur ka ndryshime në detyrimet e subjekteve raportuese.

**Trajnimi i synuar u ofrohet punonjësve përkatës** – Të gjithë punonjësit përkatës duhet t'i nënshtrohen trajnimit për LPP/LFT për të siguruar që proceset e biznesit të shpjegohen dhe të kuptohen rregulloret, procedurat dhe rreziqet e LPP/LFT-së. Punonjësit përkatës përfshijnë punonjësit që janë përballë klientëve, si dhe ata që janë të përfshirë në përpunimin e transaksioneve. Trajnimi duhet t'i drejtohet rolit specifik të punonjësit. Trajtime më të përgjithshme për LPP/LFT-në mund t'u ofrohen atyre punonjësve që nuk kanë kontakte të drejtpërdrejta me klientët ose transaksionet.

**Punonjësit e rinj duhet të trajnohen përpara se të ndërveprojnë me klientët** - Trajnimi për LPP/LFT-në duhet të integrohet brenda orientimit fillestar të punonjësit. Trajnimi duhet të kryhet nga punonjësi i ri përpara se të ndërveprojë me klientët.

**Programi i trajnimit rishikohet çdo vit** - Programi i trajnimit duhet të rishikohet të paktën në baza vjetore. Një rishikim i programit të trajnimit duhet të ndërmerret sa herë që ka ndryshime në proceset e biznesit ose kur janë miratuar ndryshime legislative ose rregullatore.

## 7.5 Auditimi i pavarur

Subjektet raportuese duhet të miratojnë aranzhime të pavarura të auditimit për të rishikuar dhe verifikuar pajtueshmërinë dhe efektivitetin e masave të marra në përputhje me Ligjin PPP/LFT.

Rishikimi mund të kryhet nga një auditor i brendshëm ose i jashtëm. Auditimi duhet të trajtojë nëse rregulloret dhe procedurat janë të vendosura dhe janë duke u respektuar, dhe nëse procedurat dhe praktikat janë në përputhje me kërkesat legislative dhe rregullatore.

### 7.5.1 Kriteret e vlerësimit- auditimi i brendshëm

**Auditimi i brendshëm është i dokumentuar** - Auditimi i brendshëm është i dokumentuar dhe përfshin fushat specifike të rishikuara nga auditori, datën kur është ndërmarrë auditimi dhe rekomandimet që janë paraqitur.

**Auditimi i brendshëm është proporcional me madhësinë e biznesit** – Ashtu si me elementët e tjerë të regjimit të pajtueshmërisë, auditimi i brendshëm duhet të marrë parasysh madhësinë e biznesit. Bizneset e mëdha si korporatat ndërkombëtare ose bizneset e bizneseve të mëdha duhet të kryejnë një auditim më gjithëpërfshirës të kryer nga një auditor i pavarur. Siç u përmend më parë në këtë seksion, subjektet më të vogla mund të marrin në konsideratë kryerjen e një vetë-rishikimi.

**Auditimi i brendshëm është gjithëpërfshirës** - Auditimi i brendshëm duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të përfshijë një analizë të rregulloreve dhe procedurave të subjektit ekonomik, programit të trajnimit dhe kornizës të menaxhimit të rrezikut. Gjatë ekzaminimit të kornizës së menaxhimit të rrezikut, auditori i brendshëm ose rishikuesi duhet të ketë rishikuar të gjithë elementët duke përfshirë vlerësimin e rrezikut, strategjitë e zbutjes së rrezikut dhe procedurat e monitorimit të rrezikut.

Rishikimi nga auditori i brendshëm ose rishikuesi duhet të përfshijë intervista, teste dhe mostra të tilla si sa vijon:

- Intervistat me ata që trajtojnë transaksionet dhe me mbikëqyrësit e tyre për të përcaktuar njohuritë e tyre për kërkesat legislative dhe rregulloret dhe procedurat tuaja;
- Një rishikim i kriterëve dhe proceseve për identifikimin dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta;
- Testimi i sistemit të mbajtjes së të dhënave për pajtueshmërinë me legjislacionin;
- Një test i procedurave të identifikimit të klientit për pajtueshmërinë me legjislacionin;
- Një rishikim i vlerësimit të rrezikut;
- Një rishikim i trajnimit LPP/LFT të ofruar për stafin; dhe
- Çdo element tjetër të përcaktuar me akt nënligjor.

**Auditimi i brendshëm duhet të kryhet të paktën çdo dy vjet.** - Auditimi ose rishikimi duhet të kryhet të paktën çdo dy vjet.

**Rezultatet e auditimit të brendshëm i raportohen Bordit të Drejtorëve ose menaxhmentit të lartë** – Rezultatet e auditimit duhet të raportohen brenda një afati të arsyeshëm kohor pas përfundimit të auditimit. Raporti duhet të përfshijë rezultatet e auditimit, çdo përditësim që i është bërë rregulloreve dhe procedurave gjatë periudhës së rishikimit dhe statusin e zbatimit të rregulloreve dhe procedurave. Çdo mangësi duhet të identifikohet dhe gjithashtu t'i raportohet menaxhmentit të lartë ose bordit të drejtorëve. Raporti duhet të përfshijë gjithashtu një kërkesë për përgjigje që tregon veprimet korrigjuese dhe një afat kohor për zbatimin e veprimeve të tilla. Data kur rezultatet e auditimit ose rishikimit iu paraqitën menaxhmentit të lartë dhe përgjigja e menaxhmentit ndaj auditimit duhet të dokumentohet.

## 8 KUJDESI I DUHUR NDAJ KLIENTIT (KDK)

Subjektet raportuese kanë detyrime sipas nenit 19 të Ligjit PPP/LFT për zbatimin e masave të kujdesit të duhur ndaj klientit.

Sipas këtij neni, subjektet raportuese identifikojnë klientët e tyre dhe verifikojnë identitetin e klientëve të tyre me anë të burimeve të pavarura, dokumenteve, të dhënave ose informacioneve të besueshme.

Kur përcakton pronësinë përfituese të një personi juridik, subjekti raportues mund të konsultojë regjistrat e korporatave, informacionet e themelimit ose informacione të tjera të disponueshme publikisht. Subjekti mund t'i kërkojë gjithashtu individit që përfaqëson personin juridik informacionin për pronarin përfitues. Përpjekjet për të përcaktuar pronarin përfitues duhet të dokumentohen. Në rast se pronari përfitues nuk mund të përcaktohet, subjekti raportues duhet ta konsiderojë marrëdhënien ose transaksionin si rrezik më të lartë dhe të zbatojë masa për zbutjen e rrezikut si dhe të marrë parasysh përshtatshmërinë e raportimit tek NjIF-i.

Gjatë përcaktimit të burimit të fondeve, subjekti raportues mund të konsultojë informacionin e disponueshëm publikisht ose të kërkojë drejtpërdrejt klientit. Përpjekjet për të përcaktuar burimin e fondeve dhe pronës duhet të dokumentohen. Në rast se burimi i fondeve nuk mund të përcaktohet, subjekti raportues duhet ta konsiderojë marrëdhënien ose transaksionin si rrezik më të lartë dhe të zbatojë masa për zbutjen e rrezikut si dhe të marrë parasysh përshtatshmërinë e raportimit tek NjIF-i.

### 8.1 Koha e identifikimit dhe verifikimit të klientit

Subjektet raportuese duhet të jenë të detyruara të kryejnë kujdesin e duhur ndaj klientit me klientët që kërkojnë të hyjnë në një marrëdhënie biznesi me të ose të kryejnë një transaksion, duke i kërkuar aplikuesit të paraqesë një dokument zyrtar i cili në mënyrë të arsyeshme mundëson për të përcaktuar identitetin e vërtetë të aplikuesit.

Kur aplikuesi për subjektin nuk ofron dëshmi të identitetit sa më shpejt të jetë e mundur, subjekti raportues nuk duhet të hapë llogarinë; të mos fillojë asnjë marrëdhënie biznesi me klientin dhe të mos kryejë transaksionin. Nëse ka filluar marrëdhënien e biznesit me klientin, duhet të ndërpresë çdo transaksion që po kryen; të përfundojë marrëdhënien e biznesit ose çdo marrëveshje që ka arritur; dhe të dorëzojë një raport të transaksionit të dyshimtë në NjIF

#### 8.1.1 Kriteret e vlerësimit-koha e identifikimit dhe verifikimit të klientit

**Kontrolli i duhur ndaj klientit kryhet përpara krijimit të marrëdhënies së biznesit** - Subjekti raportues është i detyruar të ndërmarrë masat e përcaktuara përpara krijimit të marrëdhënies afariste.

**Përpara kryerjes së transaksioneve prej 10,000 euro ose më shumë-** Subjekti raportues është i detyruar të kryejë masat e KDK-së kur kryen transaksione prej 10,000 euro ose më shumë, qofshin ato të kryera në një ose disa transaksione të ndërlidhura.

**KDK-ja kryhet kur ka dyshime për besueshmërinë dhe vërtetësinë e informacionit të dhënë.** Kontrolli i duhur ndaj klientit kryhet kur ka dyshime për besueshmërinë dhe vërtetësinë e informacionit të marrë më parë nga klienti ose nga pronari përfitues.

**KDK-ja kryhet kur ekziston dyshimi për PP/FT.** Subjektet raportuese duhet të kryejnë kujdesin e duhur ndaj klientit në të gjitha rastet kur ka arsye për dyshime për pastrim parash ose financim terrorizmi në lidhje me një transaksion ose një klient, pavarësisht nga vlera e transaksionit.

## 8.2 Masat për kryerjen e kujdesit të duhur ndaj klientit

### 8.2.1 Masa për identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit të klientit

Subjekti raportues duhet të identifikojë personat fizikë, personat juridikë dhe marrëveshjet juridike, si dhe të identifikojë dhe verifikojë pronarët përfitues dhe të kryejë verifikimin e individëve që pretendojnë se veprojnë në emër të një klienti.

Subjekteve raportuese nuk u kërkohet të verifikojnë një klient kur ai tashmë ka ofruar prova të kënaqshme të identitetit, përveç nëse keni dyshime për vërtetësinë e informacionit të marrë.

#### ➔ Vlerësimi - masat për të kryer KDK-në

**Informacioni i saktë mblidhet për të gjitha situatat.** Subjektet raportuese duhet të mbledhin informata për identitetin, qëllimin dhe natyrën e biznesit ose aktivitetit kryesor, statusin financiar dhe kapacitetin në të cilin klienti po hyn në marrëdhënie biznesi.

**Identifikohen personat fizik dhe verifikohet identiteti** - Subjekti raportues identifikon personat fizik dhe verifikon paraqitjen e identitetit të tyre përmes një dokumenti zyrtar origjinal, të paskaduar, dhe që mban fotografinë e personit. Adresa e personit dhe data e lindjes do të verifikohen duke paraqitur një dokument, ose dokumente, të cilat ofrojnë dëshmi.

**Natyra dhe qëllimi i synuar i marrëdhënies së biznesit duhet të dokumentohet dhe kuptohet.**

**Identiteti i personave juridikë është verifikuar.** Subjekti raportues duhet të mbledhë të dhënat e mëposhtme për personin juridik ose korporatën:

- a. Emrin e korporatës;
- b. Adresën e zyrës qendrore;

- c. Identitetet e drejtorëve duke përfshirë emrin, datën dhe vendin e lindjes, adresën e banimit dhe kopjen e vërtetuar të numrit kombëtar të identifikimit;
- d. Dëshminë e inkorporimit ose dëshmi të ngjashme të statusit juridik dhe formës juridike;
- e. Dispozitat që rregullojnë autoritetin për të detyruar personin juridik; dhe
- f. Informacionin që është i nevojshëm për të kuptuar pronësinë dhe kontrollin e personit juridik.

**Identiteti i marrëveshjeve ligjore është verifikuar.** Subjekti raportues duhet të mbledhë të dhënat e mëposhtme në lidhje me rregullimin ligjor:

- a. Emrin;
- b. Formën ligjore dhe dëshminë e ekzistencës;
- c. Adresën e selisë ose të vendit kryesor të biznesit;
- d. Kompetencat që rregullojnë dhe detyrojnë marrëveshjen;
- g. Identitetin e themeluesit, të besuarit, mbrojtësit, duke përfshirë emrin, datën dhe vendin e lindjes, adresën e banimit dhe kopjen e vërtetuar të numrit kombëtar të identifikimit; dhe
- e. Aty ku është e zbatueshme, përfituesit ose klasa e përfituesve dhe çdo person tjetër fizik që ushtron kontroll efektiv përfundimtar mbi trustin, duke përfshirë një zinxhir kontrolli ose pronësie, dhe çdo palë tjetër me autoritet për të menaxhuar, ndryshuar ose ndryshe kontrolluar marrëveshjen.

**Identifikimi i përfaqësuesit ligjor të një personi juridik dhe verifikimi i identitetit të përfaqësuesit ligjor.** Subjekti raportues identifikon përfaqësuesin ligjor të personit juridik dhe verifikon identitetin e përfaqësuesit ligjor, nëpërmjet ekzaminimit të një dokumenti personal identifikimi të përfaqësuesit ligjor në praninë e tij/saj, nga një dokument tjetër publik i vlefshëm i ofruar nga përfaqësuesi ligjor.

**Identifikimi dhe verifikimi i identitetit të çdo personi që vepron në emër të klientit.** Subjekti raportues do të identifikojë dhe verifikojë identitetin e personit që pretendon të veprojë në emër të një personi tjetër, si dhe identitetin e vërtetë të personit në emër të të cilit pala e tretë mund të veprojë në transaksionin e propozuar.

**Pronarët përfitues janë identifikuar.** Subjekti raportues duhet të identifikojë dhe verifikojë personat fizikë që ushtrojnë kontrollin dhe pronësinë e një personi juridik dhe marrëveshjes, nëpërmjet informacionit të mëposhtëm të marrë nga një regjistër publik ose burime të tjera të besueshme:

- a. Detajet e inkorporimit;
- b. Marrëveshjen e partneritetit;
- c. Aktin shkresor të kalimit të pronësisë tek trusti;

- d. Të dhënat e drejtorëve dhe aksionarëve, duke përfshirë emrin, datën dhe vendin e lindjes, adresën e vendbanimit dhe kopjen origjinale të vërtetuar të numrit kombëtar të identifikimit;
- e. Emrat e personave përkatës që kanë pozitë të lartë drejtuese në personin juridik ose të personit të besuar të marrëveshjes ligjore;
- f. Emrat e administratorëve të besuar, përfituesve ose të çdo personi tjetër fizik që ushtron kontroll efektiv përfundimtar mbi trustin; dhe
- g. Çdo dokumentacion tjetër i marrë nga një burim i pavarur i besueshëm që vërteton emrin, formën dhe ekzistencën aktuale të klientit.

**Subjektet raportuese mbledhin informacion të plotë dhe të saktë kur kryejnë një transaksion ose vendosin një marrëdhënie biznesi me një klient që nuk është fizikisht i pranishëm.** Subjekti raportues duhet:

- a. Të marrë masa adekuate për të trajtuar rrezikun specifik të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit ose përhapjes dhe çdo veprë tjetër të ndërlikuar penale;
- b. Të sigurojë që kujdesi i duhur i kryer të mos jetë më pak efektiv, sesa kur klienti paraqitet personalisht; dhe
- c. Kërkojë prova dokumentuese shtesë ose masa plotësuese për të verifikuar ose vërtetuar dokumentet e ofruara nga klienti, ose vërtetim/certifikat konfirmuese nga ofruesit e shërbimeve financiare ose prova ose masa të tjera dokumentuese siç mund të përshkruhen.

**Kujdesi i duhur ndaj klientit kryhet për klientët, si dhe klientët ekzistues bazuar në ndjeshmërinë ndaj rrezikut.** Subjekti raportues duhet të përditësojë informacionin e kujdesit të duhur ndaj klientit për klientët, si dhe klientët ekzistues bazuar në ndjeshmërinë ndaj rrezikut.

### 8.3 Personat e ekspozuar politikisht (PEP)

Një subjekt raportues duhet të ketë sisteme të përshtatshme të menaxhimit të rrezikut për të përcaktuar nëse klienti ose pronari përfitues është një PEP vendas ose ndërkombëtar.

Neni 1.33.1 i Ligjit për PPP/LFT përcakton se **Personi i ekspozuar politikisht nënkupton** personat fizikë të huaj apo vendorë, të cilët janë ose kanë qenë të ngarkuar me funksione të larta publike dhe përfshin si në vijim:

- Udhëheqës të shtetit, udhëheqës të qeverisë, ministër, zëvendësministër, këshilltar politik, shef kabineti;
- Deputet të parlamentit dhe anëtarë të organeve të ngjashme dhe të zgjedhurit nga parlamenti;
- Anëtarë të organeve drejtuese qendrore të subjekteve politike;



- Anëtarë të gjykatës kushtetuese, gjykatës supreme apo ndonjë trupi tjetër gjykues të nivelit të lartë gjyqësor ose ushtarak ndaj vendimeve të të cilit nuk mund të ushtrohet ankesë, përveç se në rrethana të jashtëzakonshme;
- Anëtarë të Zyrës Kombëtare të Auditimit, të gjykatës së auditorëve dhe bordeve të bankave qendrore;
- Ambasador apo *chargés d'affaires* apo oficer i rangut të lartë ushtarak;
- Anëtarë të bordit, administratorë, menaxherë apo mbikëqyrës të ndërmarrjeve në pronësi të shtetit;
- Drejtorë, zëvendësdrejtorë dhe anëtarë të bordeve ose funksione ekuivalente në organizatat ndërkombëtare.

Neni 1.33.2 i Ligjit për PPP/LFT përcakton anëtarët e familjes së personave të ekspozuar politik si në vijim:

- Bashkëshorti apo çdo person që konsiderohet si ekuivalent me bashkëshortin;
- Fëmijë dhe bashkëshortët e fëmijëve apo personat që konsiderohet si ekuivalent me bashkëshortin;
- Prindërit.

Neni 1.33.3 i Ligjit për PPP/LFT përcakton bashkëpunëtorët e ngushtë me personat e ekspozuar politik si:

- Çdo person fizik i cili njihet se janë pronar të përbashkët përfitues të personave juridikë apo marrëveshjeve juridike, ose çfarëdo marrëdhënie e ngushtë biznesi, me personat e specifikuar në paragraf.

Çdo person fizik i cili është pronar përfitues i personit juridik apo marrëveshjes juridike e cila njihet se është themeluar për përfitime de facto të personit të specifikuar në paragraf.

### 8.3.1 Kriteret e vlerësimit - Personat e ekspozuar politikisht

**Përcaktimi i PEP-ve kryhet dhe dokumentohet në situata të përcaktuara (shih seksionin 3.4).** Nga subjektet raportuese kërkohet të përcaktojnë ekzistencën e PEP dhe të dokumentojnë përcaktimin e tyre.

**Menaxhmenti i lartë miraton marrëdhëniet e biznesit me PEP-të.** Subjektet raportuese duhet të kenë procedura për krijimin e marrëdhënieve të biznesit me PEP-të, duke përfshirë rolin e menaxhmentit në miratimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies me PEP bazuar në rrezik.

**Burimi i pasurisë dhe i fondeve përcaktohet kur klienti ose pronari përfitues është një PEP.**

**Merren informacione për anëtarët e ngushtë të familjes ose bashkëpunëtorët e ngushtë të PEP-it.**

**Dokumentohet qëllimi i transaksionit ose llogarisë, si dhe vëllimi dhe natyra e pritshme e aktivitetit të llogarisë.**

**Rishikohen burimet publike të informacionit për PEP-in.** Subjekti raportues duhet të konsultohet me burime publike duke përfshirë internetin për të përcaktuar nëse ka ndonjë indikacion se PEP-i ka qenë i përfshirë në korrupsion ose në aktivitete të tjera kriminale.

**Monitorimi i vazhdueshëm i zgjeruar kryhet kur klienti ose pronari përfitues është PEP.** Transaksionet e ndërmarra nga PEP-të duhet t'i nënshtrohen monitorimit më të shpeshtë.

#### 8.4 Kujdesi i duhur i shtuar

Përderisa subjekti raportues duhet të zbatojë masat e kujdesit të duhur ndaj klientit, disa situata kërkojnë zbatimin e masave të kujdesit të duhur të shtuar në mënyrën dhe në rastet e përcaktuara me Ligjin për PPP/LFT. Kujdesi i duhur i shtuar ndaj klientit duhet të zbatohet për personat dhe subjektet që paraqesin rrezik më të lartë për subjektet raportuese.

Subjekti raportues mund të zbatojë gjithashtu kujdes të duhur të shtuar kur subjekti raportues gjykon se rreziku i pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit është më i madh për shkak të natyrës së marrëdhënies së biznesit, formës dhe mënyrës së ekzekutimit të transaksionit, profilit të biznesit të klientit ose rrethanave të tjera që lidhen me klientin. Subjektet raportuese do të zbatojnë masa të shtuara të kujdesit të duhur në rastet e mëposhtme:

**Personat e ekspozuar politikisht** - vendosja e një marrëdhënie biznesi ose kryerja e një transaksioni me një klient që është person i ekspozuar politikisht;

**Jo ballë për ballë** - në rastet kur klienti nuk është i pranishëm personalisht gjatë identifikimit dhe verifikimit të identitetit dhe gjatë zbatimit të masave të kujdesit të duhur (jo ballë për ballë);

**Teknologjitë e reja** - në rastet kur përdoren teknologji të reja që ofrojnë anonimitet. Kjo mund të përfshijë monedha virtuale, karta me vlerë të ruajtur, transfere bankare përmes telefonit celular, etj.;

**Rrezik më i lartë PP/FT/FP** - Subjekti raportues do të zbatojë masat e kujdesit të duhur ndaj klientit në rrethana që konsiderohen me rrezik të lartë, sipas vlerësimit të rrezikut të subjektit raportues.

Masat e shtuara të kujdesit të duhur përfshijnë strategjitë e zbutjes së rrezikut të listuara në Shtojcën 4.

#### 8.4.1 Kriteret e vlerësimit, kujdesi i duhur i shtuar

**Kujdesi i duhur i shtuar ndaj klientëve kryhet në rrethana me rrezik më të lartë.** Kujdesi i duhur i shtuar zbatohet tek 1) personat e ekspozuar politikisht 2) në situata të identifikimit të klientëve jo-ballë për ballë 3) ku përdoren teknologji të reja që ofrojnë anonimitet, dhe 4) në situata me rrezik më të lartë të PP/FT-së.

**Masat e duhura zbatohen kur kërkohet kujdes i duhur i shtuar.** Subjekti raportues zbaton masat e mëposhtme në situata me rrezik më të lartë:

- a. Marrjen e informacionit të mëtejshëm që mund të ndihmojë në përcaktimin e identitetit të klientit;
- b. Zbatimin e masave shtesë për verifikimin e dokumenteve të dorëzuara;
- c. Marrjen e miratimit të menaxhmentit të lartë për marrëdhëniet ose transaksionet e reja të biznesit;
- d. Përcaktimin e burimit të pasurisë dhe burimit të fondeve të personit ose subjektit; dhe
- e. Kryerjen e monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit.

#### 8.5 Kujdesi i duhur i thjeshtësuar

Kur subjektet raportuese identifikojnë fusha me rrezik më të ulët, mund të zbatohen masa të kujdesit të duhur të thjeshtësuara ndaj klientit. Përpara aplikimit të masave të kujdesit të duhur të thjeshtësuar, subjektet raportuese duhet të përcaktojnë se marrëdhënia ose transaksioni me klientin përfaqëson një nivel të ulët rreziku bazuar në një vlerësim gjithëpërfshirës të rrezikut të PP/FT-së që vlerëson rrezikun që lidhet me llojet e klientëve, vendndodhjen gjeografike të vendeve, produktet specifike, shërbimet, mekanizmat dhe kanalet e shpërndarjes.

Kur zbatohet kujdesi i duhur i thjeshtësuar, subjekti raportues duhet të respektojë identifikimin dhe verifikimin e klientit, si dhe kërkesat e monitorimit dhe raportimit të transaksioneve.

Shembuj të masave të kujdesit të duhur të thjeshtësuar përfshijnë:

- Verifikimi i identitetit të klientit dhe pronarit përfitues pas krijimit të marrëdhënies së biznesit (p.sh., nëse transaksionet e llogarisë rriten mbi një prag monetar të përcaktuar).
- Reduktimi i shpeshtësisë së përditësimeve të identifikimit të klientit.
- Ulja e shkallës së monitorimit dhe shqyrtimit të vazhdueshëm të transaksioneve, bazuar në një prag të arsyeshëm monetar.
- Mos mbledhja e informacionit specifik ose kryerja e masave specifike për të kuptuar qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit, por nxjerrja e qëllimit dhe natyrës nga lloji i transaksioneve ose marrëdhënieve të krijuara të biznesit.

Masat e KDK-së të thjeshtësuar nuk janë të pranueshme sa herë që ekziston dyshimi për pastrim parash ose financim terrorizmi, ose kur zbatohen skenarë specifikë me rrezik më të lartë.

#### *8.5.1 Kriteret e vlerësimit - kujdesi i duhur i thjeshtësuar*

**Kujdesi i duhur i thjeshtësuar zbatohet pas një vlerësimi të dokumentuar të rrezikut të PP/FT-së që përcakton se një klient ose transaksion është me rrezik më të ulët.** Masat e thjeshtuara të kujdesit të duhur, mund të zbatohen vetëm për klientët që janë përcaktuar se kanë një rrezik të ulët të PP/FT-së.

**Identifikimi dhe verifikimi i klientit, si dhe detyrimet e monitorimit dhe raportimit të transaksioneve vazhdojnë të zbatohen për klientët dhe situatat me rrezik të ulët.** Nëse subjekti raportues vendos se dëshiron të aplikojë masa të thjeshtuara të kujdesit të duhur për klientët dhe situatat me rrezik më të ulët, ai duhet të jetë në përputhje me identifikimin dhe verifikimin e klientit, si dhe me kërkesat e monitorimit dhe raportimit të transaksioneve.

## 9 MONITORIMI DHE RAPORTIMI I VAZHUESHËM

### 9.1 Monitorimi dhe raportimi i vazhdueshëm

Subjektet raportuese duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur në monitorimin e aktivitetit të biznesit të kryer nga klientët e tyre, duke siguruar kështu njohuri për biznesin e klientit, burimin e fondeve, natyrën dhe qëllimin e synuar të marrëdhënies së biznesit, operacionet ose transaksionet e klientit. Monitorimi i vazhdueshëm nuk kërkohet kur nuk është vendosur asnjë marrëdhënie biznesi.

#### 9.1.1 Kriteret e vlerësimit-monitorimi dhe raportimi i vazhdueshëm

**Marrëdhëniet e biznesit monitorohen.** Monitorimi i vazhdueshëm kryhet në bazë të ndjeshmërisë ndaj rrezikut tek klientët dhe situatat me rrezik më të lartë që monitorohen më shpesh. Më konkretisht, subjektet raportuese do të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme të gjitha transaksionet e ndërlikuara, të pazakonta, të dyshimta ose të mëdha qofshin të përfunduara ose jo, si dhe transaksionet që nuk kanë një qëllim të dukshëm ekonomik ose të ligjshëm.

**Vëmendje e veçantë i kushtohet marrëdhënieve të biznesit me persona, persona juridikë dhe marrëveshje nga ose në vende që nuk i zbatojnë ose i zbatojnë në mënyrë të pamjaftueshme standardet përkatëse për të luftuar PP/FT-në.** Subjektet duhet të konsultojnë listën e FATF<sup>9</sup> të juridiksioneve me rrezik më të lartë dhe juridiksioneve me mangësi strategjike. Qëllimi i monitorimit është të përcaktojë nëse treguesit e PP/FT/FP janë të pranishëm dhe nëse një raport i RDT-së është i nevojshëm.

**Informacioni mbahet i përditësuar për marrëdhëniet e vazhdueshme të biznesit.** Dokumentet dhe të dhënat që disponon subjekti raportues duhet të mbahen të përditësuara dhe masat duhet të përshtaten me nivelin e rrezikut të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

**Është kryer kontrolli i vazhdueshëm i klientëve.** Subjekti raportues kryen kontroll të vazhdueshëm për klientët e tij dhe zhvillon sisteme dhe procedura të bazuara në rrezik.

### 9.2 Transaksione të ndërlikuara, të pazakonta dhe të mëdha

Subjektet raportuese duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve të ndërlikuara dhe jashtëzakonisht të mëdha, si dhe çdo formë të pazakontë transaksionesh pa një qëllim të dukshëm ekonomik ose të ligjshëm, edhe në rastet kur arsyet për dyshimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit ose përhapjes nuk janë zbuluar ende në lidhje me transaksione të tilla.

<sup>9</sup> Lista e FATF me rrezik më të lartë dhe juridiksionet e monitoruara mund të gjendet në: [https://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/?hf=10&b=0&s=desc\(fatf\\_releasedate\)](https://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/?hf=10&b=0&s=desc(fatf_releasedate)) qasur më 23 qershor 2022.

Subjektet raportuese duhet gjithashtu të analizojnë sfondin dhe qëllimin e transaksioneve të tilla dhe të paraqesin me shkrim gjetjet e rezultateve të analizës. Këto duhet t'i vihen në dispozicion me kërkesë NjIF-it, autoriteteve mbikëqyrëse dhe ligj zbatuese. Megjithatë, subjektet raportuese duhet të raportojnë të gjitha transaksionet e dyshimta.

### **9.2.1 Kriteret e vlerësimit - transaksione të ndërlikuara, të pazakonta dhe të mëdha**

**Identifikohen transaksione të ndërlikuara dhe të pazakonshme.** Subjektet raportuese duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve dhe modeleve të ndërlikuara, të pazakonta ose të mëdha, si dhe çdo forme të pazakontë transaksioni pa qëllim të dukshëm ekonomik ose të ligjshëm, edhe në rastet kur arsyet për dyshim për pastrim të parave, financim të terrorizmit ose përhapjes nuk janë identifikuar ende në lidhje me transaksione të tilla.

**Është dokumentuar analiza e historikut dhe qëllimit të transaksionit.** Gjithashtu, subjektet raportuese duhet të analizojnë historikun dhe qëllimin e transaksioneve të ndërlikuara, të pazakonta dhe të mëdha, dhe të paraqesin me shkrim gjetjet e rezultatit të analizës.

**Analiza e historikut dhe qëllimit të transaksionit është vënë në dispozicion të NjIF-it dhe organeve të tjera mbikëqyrëse.** Subjekteve raportuese i kërkohet gjithashtu që analizën ta vënë në dispozicion të NjIF-it dhe organeve të tjera mbikëqyrëse, sipas kërkesës.

### **9.3 Raportimi i transaksioneve tek NjIF-i**

Subjekti raportues është i detyruar të njoftojë NjIF-in për transaksionet e dyshimta brenda 24 orëve nga momenti i krijimit të dyshimit. Kjo kërkesë zbatohet si për transaksionet e përfunduara, ashtu edhe për ato të tentuara.

Subjekti raportues do të njoftojë NjIF-in përpara se të ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me ndonjë veprim ose transaksion të dyshimtë, i cili do të rezultonte në lirim ose transferimin e pronës që i nënshtrohet transaksionit nga kontrolli i subjektit raportues. Njoftimi mund të bëhet gojarisht, dhe njoftimi i tillë nuk përjashton detyrimin për paraqitjen e raportit me shkrim.

Pas pranimit të njoftimit, NjIF-i brenda një afati kohor prej dyzet e tetë (48) orësh do të udhëzojë subjektin raportues që të lejojë ekzekutimin e transaksionit ose të bëjë ngrirje të përkohshme në pajtim me nenin 27 të Ligjit PPP/LFT. Kur NjIF-K nuk përgjigjet brenda afatit të caktuar kohor, subjekti raportues vazhdon me ekzekutimin e transaksionit. Një udhëzim i tillë i veprimit në përputhje me këtë nen nuk do t'i komunikohet asnjë personi ose subjekti, përfshirë klientin, pa pëlqimin e NjIF-it.

NjIF-i mund t'i kërkojë subjektit raportues që raporton RTD-në t'i japë të dhënat për çfarëdo çështje në lidhje me dyshimin me të cilin lidhet raporti dhe arsyet mbi të cilat ai bazohet.

Duhet të theksohet se subjekti raportues, drejtorët, menaxherët, zyrtarët, ortakët, profesionistët dhe punonjësit nuk mund t'i nënshtrohen procedimeve penale, civile,

disiplinore ose administrative për shkelje të rregullit bankar ose sekretit profesional, kur dorëzojnë në mirëbesim një raport transaksioni të dyshimtë.

Tutje, të gjitha transaksionet me para në të gatshme në vlerë 10,000 euro ose më shumë ose ekuivalentin e saj në çfarëdo monedhë tjetër të kryera duhet gjithashtu të raportohen menjëherë tek NjIF-i jo më vonë se 15 ditë pas kryerjes së transaksionit.

### **9.3.1 Kriteret e vlerësimit-raportimi në NjIF**

**Raportet e transaksioneve të dyshimta RTD dhe raporti i transaksionit në të gatshme (RTG) raportohen pa asnjë vonesë.** Subjekti raportues duhet t'i raportojë NjIF-it aktivitetet ose transaksionet e dyshimta që tregojnë aktivitetet e mundshme të PP/FT/FP brenda 24 orëve nga identifikimi i dyshimit. RTG-ja duhet të raportohet jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të transaksioneve.

**RTD-ja dhe RTG-ja raportohen sipas mënyrës së përcaktuar.** Do të jepet informacion i mjaftueshëm i cili tregon natyrën dhe arsyen e dyshimit, dhe kur subjekti raportues ka dokumentacion shtesë mbështetës, gjithashtu duhet të vihet në dispozicion. Të gjitha fushat e detyrueshme në formatin elektronik/ formularët e RTD dhe RTG duhet plotësuar.

**RTD-të shoqërohen me kopje të të gjithë dokumentacionit që ndërlidhet drejtpërdrejt me dyshimin.** Kjo përfshin informacionin e hapjes së llogarisë, historinë e transaksioneve si dhe arsyet mbi të cilat bazohet dyshimi.

**Subjekti raportues u përgjigjet në kohën e duhur kërkesave të bëra nga NjIF-i.** Kur një subjekt raportues merr një kërkesë informacioni nga NjIF-i, institucioni do t'i japë NjIF-it të dhënat e kërkuara ose të dhënat e mëtejshme dhe kopjet e dokumenteve në masën që këto të dhëna ose dokumente janë në dispozicion të atij personi brenda një kohe të arsyeshme nga data e marrja e kërkesës.

**Subjekti raportues nuk jep informacion se një RTD është raportuar.** Subjekti raportues nuk duhet t'ia zbulojë asnjë personi të paautorizuar dyshimin për PP/FT/FP, veçanërisht personit ose subjektit që është subjekt i raportit. Ky ndalim e përjashton subjektin raportues që të ndajë përmbajtjen e RTD-së me auditorët ose autoritetet mbikëqyrëse të ndryshme nga NjIF-i.

## **10 MBAJTJA E SHËNIMEVE**

### **10.1 Mbajtja e shënimeve**

Subjektet raportuese duhet të mbajnë shënime të kujdesit të duhur ndaj klientit për një periudhë 5-vjeçare, pas ekzekutimit të transaksioni ose përfundimit të marrëdhënies së biznesit.

Informacioni specifik për klientin, marrëdhëniet e biznesit dhe transaksionet, duhet të mbahen, siç përshkruhet në kriteret e vlerësimit më poshtë.

## 10.2 Kriteret e vlerësimit: mbajtja e shënimeve

**Dokumentet ruhen për 5 vite nga data e transaksionit ose përfundimi i marrëdhënies së biznesit.** Subjektet raportuese duhet të mbajnë të dhënat e mbledhura në bazë të Ligjit PPP/LFT dhe rregulloreve si dhe dokumentacionit shoqërues për periudhën 5-vjeçare pas ekzekutimit të transaksionit ose përfundimit të një marrëdhënie biznesi. Dokumentet duhet të mbahen në një mjedis që garanton, si konfidencialitetin ashtu edhe integritetin e tyre.

**Të dhënat mbahen sipas kërkesave rregullatore.** Subjekti raportues do të mbajë të gjitha librat dhe të dhënat në lidhje me klientët dhe transaksionet e tij, siç përshkruhet në Ligjin PPP/LFT dhe duhet të sigurojë që ato të dhëna dhe informacione themelore të jenë në dispozicion në kohën e duhur për NjIF-in, autoritetin mbikëqyrës, agjencitë e zbatimit të ligjit ose autoritete të tjera kompetente. Subjekti raportues duhet të mbajë regjistrime me anë të dokumenteve origjinale në formën e kopjeve të shtypura ose në pajisje ruajtjeje elektronike.

**Subjekti raportues duhet të krijojë dhe të mbajë të dhëna për të gjitha transaksionet dhe marrëdhëniet e biznesit.** Të dhënat duhet të përfshijnë, së paku:

- a) Kopjet e dokumenteve që vërtetojnë identitetin e klientit, pronarëve të pronës, të marra në përputhje me këtë ligj, llogarive të dosjes dhe korrespondencës afariste, për të paktën pesë (5) vitet e fundit, me përfundimin e marrëdhënies afariste;
- b) Informacionet e marra në përputhje me dispozitat e këtij ligji, për të mundësuar rindërtimin e transaksioneve, të cilat janë kryer ose tentuar të realizohen, nga klientët dhe raportet me shkrim të përcaktuara në përputhje me nenin 25 të Ligjit LPP/LFT, për të paktën pesë (5) vite pas përpjekjes për të ekzekutuar ose ekzekutimit të një transaksioni.
- c) Kur të dhënat e transaksionit i referohen një sërë transaksionesh të përsëritura të ndërlydhura, periudha e ruajtjes pesë (5) vjeçare fillon me ekzekutimin e transaksionit të fundit të serisë.
- d) Kur informacioni i transaksionit ka të bëjë me një raport të dorëzuar në NjIF-K në lidhje me një vepër apo transaksion të dyshimtë, periudha pesë (5) vjeçare do të fillojë me datën e dorëzimit të raportit në përputhje me nenin 26 të Ligjit LPP/LFT.

## 11 DEGËT DHE FILIALET E HUAJA

### 11.1 Kërkesat e LPP/LFT-së zbatohen për degët dhe filialet e huaja

Subjektet raportuese që kanë degë të huaja dhe filiale me shumicë në pronësi, do të kërkojnë që ata të zbatojnë kërkesat e LPP/LFT/FP në masën që e lejon ligji vendor.

Kur legjislacioni i vendit të tretë, nuk lejon zbatimin e disa prej masave të pastrimit të parave, parandalimit të financimit të terrorizmit dhe përhapjes brenda fushëveprimit të përcaktuar me Ligjin LPP/LFT, subjektet raportuese duhet të informojnë autoritetin e tyre



mbikëqyrës dhe të marrin masa adekuate për eliminimin e rrezikut të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

Subjektet raportuese duhet të informojnë rregullisht degët e huaja dhe filialet me shumicë në pronësi për kontrollet e brendshme në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe përhapjen , si dhe financimit të terrorizmit, veçanërisht në aspektin e kujdesit të duhur ndaj klientit, ofrimit të të dhënave dhe informacionit, mbajtjes së të dhënave dhe rrethanave të tjera të rëndësishme që ndërlikohen parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

## 11.2 Kriteret e vlerësimit – Degët dhe filialet e huaja

**Subjekti raportues zhvillon politika dhe procedura për shkëmbimin e informacionit brenda grupit.** Këto politika dhe procedura duhet të përshkruajnë mënyrën se si do të shkëmbehet informacioni, si dhe masat për të siguruar garancitë e duhura për konfidencialitetin dhe përdorimin e informacionit të shkëmbyer.

**Procedurat e brendshme u komunikohen degëve dhe filialeve të huaja.** Për të qenë efektive në përmbushjen e kësaj kërkesë, subjektet raportuese duhet të sigurojnë që masat e pastrimit të parave, parandalimit të financimit të terrorizmit dhe përhapjes të zbatohen me shtrirje të barabartë në degët dhe filialet e tyre të huaja dhe që t'i informojnë rregullisht për procedurat e brendshme në lidhje me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe parandalimin dhe zbulimin e përhapjes.

**Dega apo filiali i huaj duhet të zbatojë detyrimet e ligjit PPP/LFT të cilat janë më të rrepta.** Shënimi interpretues i FATF-së mbi Rekomandimin 18 thotë se “ku kërkesat minimale të ligjit PPP/LFT-së të vendit pritës janë më pak të rrepta se ato të vendit të origjinës, subjekteve raportuese duhet t'u kërkohej të sigurojnë që degët dhe filialet e tyre me shumicë në pronësi të si në vendet pritëse të zbatojnë kërkesat e vendit të origjinës, në masën që ligjet dhe rregulloret e vendit pritës e lejojnë”.<sup>10</sup>

**Subjekti raportues informon NjIF-in nëse një degë ose filial i huaj nuk mund të zbatojë aspekte të procedurave të brendshme për shkak të një konflikti me ligjet e vendit pritës.** Kur ligji vendas i një dege apo filiali të huaj pengon zbatimin e procedurave të brendshme të subjektit raportues, kjo duhet t'i komunikohet NjIF-it.

**Procedurat e brendshme duhet të përfshijnë politika dhe procedura për shpërndarjen e informacionit.** Shënimi interpretues i FATF-së mbi Rekomandimin 18 thotë se “programet e subjekteve raportuese (kundër PP/FT) duhet të përfshijnë rregullore dhe procedura për

<sup>10</sup> FATF (2012), *Standardet ndërkombëtare për luftimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe përhapjes, Rekomandimet FATF*, përditësuar në mars 2022, f.85.

shpërndarjen e informacionit të kërkuar për qëllimet e menaxhimit të rrezikut të KDK-së dhe PP/FT-së. Funkcionet e pajtueshmërisë, auditimit dhe/ose LPP/LFT-së në nivel grupi duhet t'i sigurohen klientëve (...) dhe informacionit të transaksionit nga degët dhe filialet kur është e nevojshme për qëllime të LPP/LFT-së. Kjo duhet të përfshijë informacionin dhe analizën e transaksioneve ose aktiviteteve që duken të pazakonta (nëse është bërë një analizë e tillë); dhe mund të përfshijë RTD, informacionin e tij themelor, ose faktin që një RTD është dorëzuar. Në mënyrë të ngjashme, degët dhe filialet duhet të marrin një informacion të tillë nga këto funksione në nivel grupi kur është e rëndësishme dhe e përshtatshme për menaxhimin e rrezikut. ”<sup>11</sup>.

**Megjithatë, në rastet e një RTD-je të dorëzuar,** kjo duhet të lexohet në harmoni me paragrafin 4 të nenit 26 të Ligjit për PPP/LFT.

**Subjekti raportues kryen auditime periodike për të siguruar që degët dhe filialet e huaja zbatojnë procedurat e brendshme.** Subjektet raportuese duhet të kryejnë auditim periodik për të siguruar që kontrollet e brendshme janë zbatuar në mënyrë efektive. Çdo mospërputhje në zbatim u bëhet me dije partnerëve të firmës ligjore.

---

<sup>11</sup>Po aty, f.85.

## 12 MONITORIMI I FINANCIMIT TË TERRORIZMIT DHE FINANCIMIT TË PËRHAPJES

### 12.1 Monitorimi i FT/FP-së

Si subjekt raportues, ju duhet të monitoroni nëse keni pronë në zotërimin ose kontrollin tuaj që e dini se është në pronësi ose kontrollim nga ose në emër të një terroristi ose një grupi terrorist ose që lidhet me financimin e përhapjes. Kjo përfshin informacion në lidhje me çdo transaksion ose transaksion të tentuar në lidhje me atë pronë.

Kur besoni se çfarëdo prone në zotërimin ose kontrollin tuaj është në pronësi ose kontrolluar nga ose në emër të një personi të listuar, ose pasi të jetë bërë ose propozuar ndonjë transaksion për një pronë të tillë, një raport për terrorizëm TFR duhet t'i dërgohet NJiF-it pa vonesë. Nëse e dini se transaksioni ndërlidhet me pronën në pronësi ose të kontrolluar nga ose në emër të një personi të listuar, nuk duhet ta përfundoni atë transaksion. Kjo, për shkak se një pronë e tillë duhet të ngrihet në bazë të Ligjit përkatës për Zbatimin e Sanksioneve financiare ndërkombëtare të Shënjestruara.

Nëse nuk jeni të sigurt se keni të bëni me një person të listuar, por dyshoni se mund të jetë, atëherë nëse transaksioni është përfunduar, duhet të dërgohet një raport i transaksionit të dyshimtë në NjIF.. Ju gjithashtu duhet të plotësoni një raport të transaksionit të dyshimtë, nëse transaksioni i dyshimtë është tentuar.

Lista e sanksioneve financiare të shënjestruara në lidhje me financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes mund të gjendet në: uebsajtin e Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës në: [fiu.rks-gov.net](http://fiu.rks-gov.net)

Për më tepër, subjekteve raportuese mund t'u kërkohet të aplikojnë kujdes të duhur të shtuar , në përpjesëtim me rreziqet, për marrëdhëniet e biznesit dhe transaksionet me persona fizikë dhe juridikë (përfshirë institucionet financiare) nga vendet për të cilat kjo kërkohet nga FATF-i.<sup>12</sup>

### 12.2 Kriteret e vlerësimit Monitorimi i FT-së dhe FP-së

**Subjektet raportuese do të monitorojnë listat e vëzhgimit në lidhje me financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes** – Subjektet raportuese duhet të vendosin rregullore dhe procedura për filtrimin e listës së vëzhgimit, duke përdorur një qasje të bazuar në rrezik, për të zbuluar, përputhur dhe filtruar nëse klientët, ose zyrtarët e menaxhimit të lartë, pronarët përfitues ose homologët tregtarë të klientëve janë individë, persona juridikë ose organizata të sanksionuara nga ligji vendas ose terroristë ose grupe terroriste të identifikuar ose hetuar nga një qeveri e huaj ose një organizatë ndërkombëtare si Organizata e Kombeve të Bashkuara.

<sup>12</sup> Lista e vendeve të listuara nga FATF përmes deklaratave publike mund të gjendet në: [https://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/?hf=10&b=0&s=desc\(fatf\\_releasedate\)](https://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/?hf=10&b=0&s=desc(fatf_releasedate)).

**Politikat dhe procedurat për filtrimin e listës së vëzhgimit duhet të jenë gjithëpërfshirëse.** Ato duhet të përfshijnë të paktën procedurat e zbatimit dhe standardet e vlerësimit dhe të dokumentohen.

**Fondet dhe pasuritë që lidhen me terrorizmin ose financimin e përhapjes duhet të ngrihen dhe t'i raportohen NjIF-it.** Nëse subjekti raportues përcakton se fondet ose pronat janë të lidhura me FT-në ose FP-në, ai duhet të ngrijë fondet ose pasuritë dhe duhet t'ia raportojë ato NjIF-it. Subjekti raportues duhet të dokumentojë emrin dhe operacionet e filtrimit të llogarisë së tij dhe të mbajë të dhënat për 5 vite nga data e dëshmisë pozitive.

**Kundërmasat dhe kujdesi i duhur i shtuar zbatohen për vendet e listuara nga Task Forca e Veprimit Financiar (FATF).** Subjekti raportues zbaton kundërmasa dhe masa të shtuara të kujdesit të duhur ndaj vendeve që janë identifikuar nga FATF-i si me mangësi strategjike. Një listë e masave zbutëse jepet në Shtojcën 4.

## 13 ÇFARË DUHET PRITUR GJATË NJË INSPEKTIMI TË SIPAS LIGJIT PËR PPP/LFT

### 13.1 Çfarë duhet pritur nga stafi i autoritetit mbikëqyrës

#### a) Profesionalizëm

Qasja e autoritetit mbikëqyrës për të siguruar pajtueshmërinë është bashkëpunuese. Subjektet raportuese duhet të presin që të trajtohen me profesionalizëm dhe mirësjellje. Stafi i NjIF-it duhet të mbaj standarde të larta profesionale.

#### b) Mbrojtje të informacionit tuaj

Informacioni personal, transaksional dhe financiar do të mbrohen nga përdorimi ose zbulimi i paautorizuar.

#### c) Informacion dhe ndihmë

Zyrtarët e NjIF-it përpiqen të shpjegojnë qartë dhe në mënyrë të vazhdueshme kërkesat e LPPP/LFT/FP dhe të lehtësojnë kuptimin tuaj të detyrimeve ligjore. Përveç kësaj, NjIF-i do të punojë me organet e tjera mbikëqyrëse të LPP/LFT-së për të ndihmuar subjektet raportuese duke publikuar një udhëzues dhe një listë të treguesve të PP/FT/FP. Nëse keni nevojë për informacion ose ndihmë, mos hezitoni të kontaktoni NjIF-in në adresën e mëposhtme: [fic@fic-ks.org](mailto:fic@fic-ks.org) dhe përmes kanalit të sigurt të komunikimit: Tabela e mesazheve (goAML).

### 13.2 Kërkesat për informacion nga autoriteti mbikëqyrës

Për t'u siguruar që subjektet raportuese përmbushin detyrimet e tyre, autoriteti mbikëqyrës ka qasje bashkëpunuese. Ndërsa ushtron autoritetin e tij për të shqyrtuar pajtueshmërinë, NjIF-i është i përkushtuar të punojë me subjektet raportuese në një partneritet që rrit integritetin e sistemeve financiare dhe jofinanciare të Kosovës dhe promovon siguri më të madhe publike.

Normalisht, një zyrtar i NjIF-it do të japë njoftim paraprak për inspektimin i cili do të planifikohet, qoftë me telefon dhe do të konfirmohet në një shkresë ose e-mail tek subjekti raportues që do të inspektohet. Para se të dal në terren, zyrtari i NjIF-it mund të kërkojë dokumentacion duke përfshirë kontrollet tuaja të brendshme, rregulloret dhe procedurat, vlerësimin e rrezikut të PP/FT-së, rishikimin vjetor të rregulloreve dhe procedurave, mostrat e dokumentacionit të transaksionit, si dhe dokumente të tjera. Kjo do të lejojë që një pjesë e inspektimit të fillojë përpara terrenit dhe rrjedhimisht do të kufizojë sasinë e kohës që zyrtari i NjIF-it do të qëndrojë në subjektin tuaj.

### 13.3 Gjatë inspektimit në terren

Siç u përmend më parë, do t'ju jepet njoftim paraprak për një inspektim në terren. Në rrethana të jashtëzakonshme kur NjIF-K e konsideron të nevojshme, nuk do të jepet asnjë njoftim paraprak. Ligji për PPP/LFT-së i jep NjIF-it fuqinë për të hyrë në një subjekt raportues dhe për të kryer një inspektim në terren pa njoftim paraprak.

Në përfundim të inspektimit, zyrtari i NjIF-it do të bëjë një procesverbal me të gjeturat. Njëraport që përshkruan çdo mangësi do të ofrohet nga NjIF-i, pas inspektimit në terren. Subjekteve raportuese në rastet kur është e aplikueshme do t'u kërkohet gjithashtu një plan veprimi dhe afate kohore për të korrigjuar çdo mangësi.

### 13.4 Çfarë do të kontrollohet

Një inspektim i PP/LFT/FP nga NjIF-i do të përqipet të përcaktojë nëse subjekti po përmbush detyrimet e tij sipas legjislacionit. **Kriteret e vlerësimit** të listuara në këtë udhëzues ofrojnë një listë të dobishme të fushave që mund të kontrollohen nga zyrtarët e autorizuar. Sigurimi i këtyre kriterëve të vlerësimit për subjektet raportuese promovon bashkëpunimin, transparencën dhe eliminon të papriturat për subjektet raportuese për sa i përket fushave që mund të shqyrtohen nga një zyrtar i NjIF-it. Kjo është efektive dhe efikase si për subjektet raportuese ashtu edhe për NjIF-in. Është gjithashtu një mjet i dobishëm për subjektet raportuese në testimin e zbatimit të rregulloreve dhe procedurave të tyre gjatë rishikimit të tyre vjetor. Në mënyrë të përmbledhur, disa fusha të inspektimit mund të përfshijnë:

- Miratimin e një programi për të luftuar PP/FT/FP;
- Emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë me autoritetin dhe rolin e duhur;
- Zbatimin e qasjes së bazuar në rrezik;
- Zbatimin e rregulloreve dhe procedurave;
- Rishikimin e pranisë së një procesi të auditimit të rregulloreve dhe procedurave;
- Zhvillimin dhe zbatimin e një programi trajnimi;
- Raportimin e të gjitha transaksioneve të kërkuara;
- Zbatimin e kërkesave për identifikimin dhe mbajtjen e të dhënave të klientit;
- Zbatimin e kërkesave të sanksioneve të brendshme dhe ndërkombëtare.

Ky udhëzues do të ndihmojë subjektet raportuese të përgatiten për një inspektim nga NjIF-i.

### 13.5 Sanksionet për mos-pajtueshmëri

Përderisa, shumica e subjekteve raportuese do të përqipen të respektojnë legjislacionin dhe rregulloret për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e terrorizmit, pa dyshim disa do të kenë mangësi dhe disa nuk do të arrijnë ta respektojnë plotësisht. Ligji për PPP/LFT parasheh dënime që të aplikohen për mos-pajtueshmëri. Për të kuptuar më mirë gamën e shkeljeve dhe dënimeve të mundshme, ju lutemi konsultoni nenet 49 deri në 55 të Ligjit PPP/LFT.

Prishtinë, 17/07/2023

Behar XHEMA

UD/ Drejtor - Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës



## 14 LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1 – Cenueshmëritë e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për profesionistët ligjorë
- Shtojca 2 – Klienti, shërbimet dhe rreziku gjeografik për profesionistët ligjorë
- Shtojca 3 - Lista kontrolluese e vlerësimit të rrezikut
- Shtojca 4 - Masat për zbutjen e rrezikut

### 14.1 SHTOJCA 1 – CENUESHMËRITË E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERORIZMIT PËR PROFESIONISTËT LIGJOR<sup>13</sup>

#### FLAMUJT E KUQ PËR KLIENTIN

**Flamuri i kuq 1: Klienti është tepër i fshehtë ose i paqartë në lidhje me faktet e mëposhtme:**

- Kush është klienti?
- Kush është pronari përfitues?
- Nga vijnë paratë?
- Pse po e bëjnë këtë transaksion në këtë mënyrë apo cila është pasqyra e plotë.

#### Flamuri i kuq 2: Klienti:

- Po përdor një agjent ose ndërmjetës pa ndonjë arsye;
- Po shmang në mënyrë aktive kontaktin personal pa ndonjë arsye;
- Heziton të japë ose refuzon të japë informacion, të dhëna dhe dokumente që zakonisht kërkohen për të mundësuar ekzekutimin e transaksionit;
- Mban ose ka mbajtur më parë një pozicion publik (emërim politik ose profesional i nivelit të lartë) ose ka lidhje profesionale ose familjare me një individ të tillë dhe është i angazhuar në biznes të pazakontë privat duke pasur parasysht shpeshhtësinë ose karakteristikat e përfshira;
- Ofron dokumentacion të rremë ose të falsifikuar;
- Është subjekt juridik që nuk mund të gjendet në internet dhe/ose përdor një adresë emaili me një pjesë të pazakontë domeni si Hotmail, Gmail, Yahoo etj., veçanërisht nëse klienti është ndryshe i fshehtë ose shmang kontaktin e drejtpërdrejtë;
- Dihet se ka dënime për përfitime nga krimi, dihet se aktualisht është nën hetim për përfitime nga krimi ose ka lidhje të njohura me kriminelë;

<sup>13</sup> Task Forca e Veprimit Financiar, *Cenueshmëritë e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për profesionistët ligjorë*, 2013. Gjetet në: [https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/vulnerabilitetet\\_e\\_ML\\_dhe\\_TF\\_profesionistëve\\_ligjorë.pdf](https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/vulnerabilitetet_e_ML_dhe_TF_profesionistëve_ligjorë.pdf) qasur më 21 qershor 2022

- Është i ndërlidhur ose është bashkëpunëtor i njohur i një personi të listuar si i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në aktivitete të ndërlidhura me financimin e terrorizmit ose terrorizmin;
- Tregon njohuri të pazakontë në lidhje me standardet e zakonshme të parashikuara nga ligji në çështjen e identifikimit të kënaqshëm të klientit, futjes së të dhënave dhe raporteve të transaksioneve të dyshimta – pra – bën pyetje të përsëritura mbi procedurat e zbatimit të standardeve të zakonshme.

### **Flamuri i kuq 3: Palët:**

- Palët ose përfaqësuesit e tyre (dhe, sipas rastit, pronarët e vërtetë ose kompanitë ndërmjetëse në zinxhirin e pronësisë së personave juridikë), janë vendas, rezidentë ose të inkuorporuar në një vend me rrezik të lartë
- Palët në transaksion janë të lidhura pa ndonjë arsye të dukshme biznesi.
- Lidhjet ndërmjet palëve të një natyre familjare, punësimi, korporate ose çfarëdo natyre tjetër krijojnë dyshime për natyrën reale ose arsyen e transaksionit.
- Ka paraqitje të shumta të të njëjtave palë në transaksione për një periudhë të shkurtër kohore.
- Moshja e palëve ekzekutuese është e pazakontë për transaksionin, veçanërisht nëse ato janë nën moshën madhore, ose palët ekzekutuese janë të paaftë dhe nuk ka asnjë shpjegim logjik për përfshirjen e tyre.
- Ka përpjekje për të fshehur pronarin ose palët e vërteta në transaksion.
- Personi që aktualisht drejton operacionin nuk është një nga palët formale në transaksion ose përfaqësuesi i tyre.
- Personi fizik që vepron si përfaqësues i drejtpërdrejtë nuk paraqitet si përfaqësues i përshtatshëm.

**Flamuri i kuq 4:** Transaksioni përfshin një sasi jo-proporcionale të financimit privat, çeqeve ose parave të gatshme, veçanërisht nëse nuk është në përputhje me profilin socio-ekonomik të individit ose profilin ekonomik të kompanisë.

**Flamuri i kuq 5:** Klienti ose pala e tretë po kontribuon me një shumë të konsiderueshme në para si kolateral i dhënë nga huamarrësi/debitori në vend që thjesht t'i përdorë ato fonde drejtpërdrejt, pa shpjegim logjik.

### **Flamuri i kuq 6: Burimi i fondeve është i pazakontë:**

- Financim nga palët e treta qoftë për transaksionin ose për tarifatatimet e përfshira pa asnjë lidhje të dukshme apo shpjegim legjitim
- Fonde të marra ose të dërguara në një vend të huaj kur nuk ka lidhje të dukshme midis vendit dhe klientit
- Fonde të marra ose të dërguara në vende me rrezik të lartë.



**Flamuri i kuq 7:** Klienti përdor shumë llogari bankare ose llogari të huaja pa qëllim të arsyeshëm.

**Flamuri i kuq 8:** Shpenzimet private financohen nga një kompani, biznes ose qeveri.

**Flamuri i kuq 9:** Zgjedhja e mënyrës së pagesës është shtyrë në një datë shumë të afërt me kohën e noterizimit, në një juridiksion ku mënyra e pagesës përfshihet zakonisht në kontratë, veçanërisht nëse nuk vendoset garanci për sigurimin e pagesës, pa shpjegim logjik.

**Flamuri i kuq 10:** Është vendosur një periudhë jashtëzakonisht e shkurtër shlyerjeje pa shpjegim logjik.

**Flamuri i kuq 11:** Kreditë hipotekare paguhen në mënyrë të përsëritur dhe të konsiderueshme përpara datës së maturimit të rënë dakord fillimisht, pa shpjegim logjik.

**Flamuri i kuq 12:** Pasuria blihet me para të gatshme dhe më pas përdoret me shpejtësi si kolateral për një kredi.

**Flamuri i kuq 13:** Ekziston një kërkesë për ndryshimin e procedurave të pagesës të rënë dakord më parë pa shpjegim logjik, veçanërisht kur sugjerohen instrumente pagese që nuk janë të përshtatshme për praktikën e zakonshme të përdorur për transaksionin e urdhëruar.

**Flamuri i kuq 14:** Financimi sigurohet nga një huadhënës, qoftë person fizik ose juridik, përveç një institucioni krediti, pa shpjegim logjik apo justifikim ekonomik.

**Flamuri i kuq 15:** Kolaterali që jepet për transaksionin ndodhet aktualisht në një vend me rrezik të lartë.

**Flamuri i kuq 16:** Ka pasur një rritje të konsiderueshme të kapitalit për një kompani të themeluar së fundmi ose kontribute të njëpasnjëshme gjatë një periudhe të shkurtër kohore për të njëjtën kompani, pa shpjegim logjik.

**Flamuri i kuq 17:** Ka pasur rritje të kapitalit nga një vend i huaj, i cili ose nuk ka lidhje me kompaninë ose është me rrezik të lartë.

**Flamuri i kuq 18:** Kompania merr një injeksion kapitali ose të pasurive në atë lloj natyre, e cila është dukshëm më e lartë në krahasim me biznesin, madhësinë ose vlerën e tregut të kompanisë që vepron, pa shpjegim logjik.

**Flamuri i kuq 19:** Ka një çmim tepër të lartë ose të ulët të ndërlidhur me letrat me vlerë të transferuara, në lidhje me çdo rrethanë që tregon një tepricë të tillë (*p.sh.* vëllimi i të ardhurave, tregtia ose biznesi, lokalet, madhësia, njohja e deklaramit të humbjeve ose fitimeve sistematike) ose në lidhje me shumën e deklaruar në një operacion tjetër.

**Flamuri i kuq 20:** Transaksione të mëdha financiare, veçanërisht nëse kërkohen nga kompani të krijuara së fundmi, ku këto transaksione nuk justifikohen nga qëllimi i korporatës, aktiviteti i klientit ose grupi i mundshëm i kompanive të cilit i përket ose arsye të tjera të justifikueshme.

## FLAMUJT E KUQ NË ZGJEDHJEN E PROFESIONISTIT LIGJOR

**Flamuri i kuq 21:** Udhëzimi i profesionisti ligjor në distancë nga klienti ose transaksioni pa arsye legjitime ose ekonomike.

**Flamuri i kuq 22:** Udhëzimi i profesionisti ligjor pa përvojë në një fushë të caktuar ose pa përvojë në ofrimin e shërbimeve në transaksione të komplikuar ose veçanërisht të mëdha.

**Flamuri i kuq 23:** Klienti është i përgatitur të paguajë tarifa shumë më të larta se zakonisht, pa arsye legjitime.

**Flamuri i kuq 24:** Klienti ka ndryshuar këshilltar disa herë në një hapësirë të shkurtër kohore ose ka angazhuar shumë këshilltarë ligjorë pa arsye legjitime.

**Flamuri i kuq 25:** Shërbimi i kërkuar u refuzua nga një profesionist tjetër ose u ndërpre marrëdhënia me një profesionist tjetër.

**Flamuri i kuq 26:** Lloji i operacionit që noterizohet është në mënyrë të qartë në mospërputhje me madhësinë, moshën ose aktivitetin e personit juridik ose fizik që vepron.

## FLAMUJT E KUQ NË NATYRËN E MBAJTËSIT

**Flamuri i kuq 27:** Transaksioni është i pazakontë, *p.sh.*:

- Transaksionet janë të pazakonta për shkak të madhësisë, natyrës, shpeshtësisë ose mënyrës së ekzekutimit;
- Ka dallime të dukshme dhe shumë domethënëse midis çmimit të deklaruar dhe vlerave të përafërta aktuale në përputhje me çdo referencë që mund të japë një ide të përafërt të kësaj vlere ose sipas gjykimit të profesionistit ligjor;
- Një organizatë jofitimprurëse kërkon shërbime për qëllime ose transaksione që nuk përputhen me ato të deklaruara ose jo tipike për këtë organizatë.

**Flamuri i kuq 28:** Klienti:

- Është i përfshirë në transaksione që nuk korrespondojnë me aktivitetet e tij normale profesionale ose afariste;
- Tregon se nuk ka njohuri të përshtatshme për natyrën, objektin ose qëllimin e kryerjes profesionale të kërkuar;

- Dëshiron të krijojë ose të marrë përsipër një person ose subjekt juridik me një përshkrim të dyshimtë të qëllimit, ose një përshkrim të qëllimit që nuk ndërlidhet me aktivitetet e tij normale profesionale ose tregtare ose aktivitetet e tij të tjera, ose me një përshkrim të qëllimit për të cilin kërkohet një licencë, ndërkohë që klienti nuk ka ndërmend të marrë një licencë të tillë;
- Ndryshon shpesh strukturat juridike dhe/ose drejtuesit e personave juridikë;
- Kërkon shkurtesa ose shpejtësi të pashpjegueshme në përfundimin e një transaksioni;
- Shfaqet shumë i painteresuar për rezultatin e mbajtësit;
- Kërkon të prezantohet në institucionet financiare për të ndihmuar sigurimin e lehtësive bankare.

**Flamuri i kuq 29:** Krijimi i strukturave të ndërlikuara të pronësisë kur nuk ka arsye legjitime apo ekonomike.

**Flamuri i kuq 30:** Përfshirja e strukturave në shumë vende ku nuk ka asnjë lidhje të dukshme me klientin ose transaksionin, ose asnjë arsye tjetër legjitime ose ekonomike.

**Flamuri i kuq 31:** Inkorporimi dhe/ose blerja e aksioneve ose e letrave me vlerë të disa kompanive, ndërmarrjeve ose personave juridikë brenda një periudhe të shkurtër kohore me elementë të përbashkët (një ose disa ortakë ose aksionarë, drejtor, zyra e regjistruar e kompanisë, qëllimi i korporatës etj.) pa shpjegim logjik.

**Flamuri i kuq 32:** Ka mungesë të dokumentacionit për të mbështetur historinë e klientit, transaksionet e mëparshme ose aktivitetet e kompanisë.

**Flamuri i kuq 33:** Ka disa elementë të përbashkët midis një numri transaksionesh në një periudhë të shkurtër kohe pa shpjegime logjike.

**Flamuri i kuq 34:** Transaksionet e pronave - prapa (ose ABC), me vlerë në rritje - të shpejtë ose çmim blerjeje.

**Flamuri i kuq 35:** Transaksione të braktisura pa shqetësim për nivelin e tarifës ose pas marrjes së fondeve.

**Flamuri i kuq 36:** Ka ndryshime të pashpjegueshme në udhëzimet e dhëna, veçanërisht në minutën e fundit.

**Flamuri i kuq 37:** Mbajtësi merret ekskluzivisht me mbajtjen e dokumenteve ose mallrave të tjera, mbajtjen e depozitave të mëdha parash ose përdorimin e llogarisë së klientit pa ofruar shërbime ligjore.

**Flamuri i kuq 38:** Mungon arsyeja e bindshme tregtare/financiare/tatimore apo ligjore për transaksionin.

**Flamuri i kuq 39:** Ka një ndërlikueshmëri të shtuar në transaksion ose në strukturat e përdorura për transaksionin, dhe kjo rezulton në taksa dhe tarifa më të larta se sa duket e nevojshme.

**Flamuri i kuq 40:** Kërkohet një autorizim për administrimin ose asgjësimin e pasurive në kushte të pazakonta, ku nuk ka shpjegim logjik.

**Flamuri i kuq 41:** Investim në pasuri të paluajshme, në mungesë të ndonjë lidhjeje me vendin ku ndodhet prona dhe/ose të ndonjë përfitimi financiar nga investimi.

**Flamuri i kuq 42:** Çështjet gjyqësore zgjidhen shumë lehtë ose shpejt, me pak/asnjë përfshirje nga profesionistët ligjorë.

**Flamuri i kuq 43:** Kërkesa për pagesa ndaj palëve të treta pa arsye të vërtetuara ose transaksione përkatëse.

## 14.2 SHTOJCA 2 – KLIENTI, SHËRBIMET DHE RREZIKU GJEOGRAFIK PËR PROFESIONISTËT LIGJOR<sup>14</sup>

### *Rreziku gjeografik*

- 1) Vendet/zonat e identifikuar nga burime të besueshme se ofrojnë financim ose mbështetje për aktivitete terroriste ose që kanë përcaktuar organizata terroriste që veprojnë brenda tyre.
- 2) Vendet e identifikuar nga burime të besueshme se kanë nivele të konsiderueshme të krimit të organizuar, korrupsionit ose aktiviteteve të tjera kriminale, duke përfshirë vendet burimore ose tranzitore për drogën ilegale, trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandën dhe lojërat e paligjshme të fatit.
- 3) Vendet që i nënshtrohen sanksioneve, embargove ose masave të ngjashme të lëshuara nga organizata ndërkombëtare si Organizata e Kombeve të Bashkuara.
- 4) Vendet e identifikuar nga burime të besueshme se kanë regjime të dobëta të qeverisjes, zbatimit të ligjit dhe rregullatorëve, duke përfshirë vendet e identifikuar nga deklaratat e FATF-it si me regjime të dobëta për LPP/LFT, dhe për të cilat institucionet financiare (si dhe DNFBP-të) duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve.
- 5) Vendet e identifikuar nga burime të besueshme si jo-bashkëpunuese në dhënien e informacionit për pronësinë përfituese, përcaktimi i të cilave mund të përcaktohet nga shqyrtimi i raporteve të vlerësimit të ndërsjellë të FATF-it ose raporteve nga organizatat që gjithashtu marrin në konsideratë nivele të ndryshme bashkëpunimi, siç janë raportet e Forumit Global të OECD-së për pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare të transparencës tatimore.

### *Rreziku i klientit*

- 1) PEP-të dhe personat e ndërlidhur ngushtë me ose të afërt me PEP-të konsiderohen si klientë me rrezik më të lartë (Ju lutemi referojuni Udhëzuesit të FATF (2013) për PEP-të për udhëzime të mëtejshme se si të identifikohen PEP-të, si dhe udhëzimit administrativ të NJIF-K për personat e ekspozuar politikisht).
- 2) Klientët që kryejnë marrëdhëniet e tyre të biznesit ose kërkojnë shërbime në rrethana të pazakonta ose të papërshtatshme (siç vlerësohen në të gjitha rrethanat e përfaqësimit).
- 3) Klientët ku struktura ose natyra e subjektit ekonomik ose marrëdhënies e bën të vështirë identifikimin në kohën e duhur të pronarit përfitues të vërtetë ose të

<sup>14</sup> FATF (2019), Udhëzues për qasjen e bazuar në rrezik - Profesionistët ligjorë

interesave kontrolluese ose klientëve që përqipen të errësojnë të kuptuarit e biznesit të tyre, pronësinë ose natyrën e transaksioneve të tyre, si p.sh:

- Përdorimi i pashpjegueshëm i kompanive guaskë dhe atyre pa aktivitet, kompanive të përparme (front), personave juridikë me pronësi nëpërmjet aksioneve të emëruara ose aksioneve bartëse, kontroll përmes të emëruarve dhe drejtorëve të korporatës, personave juridikë ose marrëveshjeve juridike, ndarjes së korporatave të kompanive dhe administrimit të pasurive në vende të ndryshme, të gjitha pa ndonjë arsye të dukshme ligjore ose legjitime, tatimore, biznesi, ekonomike ose ndonjë arsye tjetër.
  - Përdorimi i pashpjegueshëm i marrëveshjeve joformale si p.sh. familja ose bashkëpunëtorët e ngushtë që veprojnë si aksionarë ose drejtorë të emëruar.
  - Ndërlikueshmëri e pazakontë në strukturat e kontrollit apo të pronësisë pa një shpjegim të qartë.
- 4) klientë kompani që operojnë një pjesë të konsiderueshme të biznesit të tyre ose kanë filiale të mëdha në vende që mund të paraqesin rrezik më të lartë gjeografik.
- 5) Klientë që identifikohen si biznese intensive me para të gatshme (dhe/ose ekuivalente me para). Këto mund të përfshijnë, për shembull:
- Bizneset e Shërbimeve të Transferimit të Parave ose Vlerave (SHTPV) (p.sh. zyrat e dërgesave, zyrat e këmbimit valutor, zyrat e këmbimit, agjentët e transferimit të parave dhe tregtarët e kartëmonedhave ose biznese të tjera që ofrojnë lehtësi për transferimin e parave). Aty ku klientë të tillë (p.sh. ofruesit e SHTPV-së) nënshtrohen dhe rregullohen për një gamë të plotë kërkesash LPP/LFT në përputhje me rekomandimet e FATF-së, kjo do të ndihmojë në zbutjen e rreziqeve.
  - Operatorë, ndërmjetës dhe të tjerë që ofrojnë shërbime në pasuri virtuale.
  - Kazino, shtëpi bastesh dhe subjekte dhe aktivitete të tjera të ndërlidhura me lojërat e fatit.
  - Tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuar.
- 6) Bizneset që ndonëse zakonisht nuk kërkojnë para të gatshme duket se kanë shuma të konsiderueshme parash.
- 7) Bizneset që mbështeten shumë në teknologjitë e reja (p.sh. platforma tregtare në internet) mund të kenë cenueshmëri të natyrshme ndaj shfrytëzimit nga kriminelët, veçanërisht ato që nuk rregullohen për LPP/LFT-në.

- 8) Organizatat jofitimprurëse ose bamirëse që angazhohen në transaksione për të cilat duket se nuk ka asnjë qëllim logjik e ekonomik ose ku duket se nuk ka asnjë ndërlidhje midis aktivitetit të deklaruar të organizatës dhe palëve të tjera në transaksion.
- 9) Klientë që përdorin ndërmjetës financiarë, institucione financiare ose profesionistë ligjorë që nuk i nënshtrohen ligjeve dhe masave adekuate të LPP/LFT-së dhe që nuk mbikëqyren në mënyrë adekuate nga autoritetet kompetente ose mbikëqyrëse.
- 10) Klientë të cilët duket se po veprojnë sipas udhëzimeve të dikujt tjetër pa zbuluar identitetin e personit të tillë.
- 11) Klientët që duket se në mënyrë aktive dhe të pashpjegueshme shmangin takimet ballë për ballë ose që japin udhëzime me ndërprerje pa arsye legjitime dhe përndryshe janë të pa-qasshëm ose shumë të vështirë për t'u arritur, kur kjo përballje normalisht do të pritej.
- 12) Klientët që kërkojnë që transaksionet të kryhen në afate kohore jashtëzakonisht të shkurta ose të përshpejtuara pa një shpjegim të arsyeshëm për përshpejtimin e transaksionit, gjë që do ta bënte të vështirë ose të pamundur për profesionistët ligjorë kryerjen e një vlerësimi të duhur të rrezikut.
- 13) Klientët që kanë dënime për krime që gjenerojnë të ardhura, të cilët udhëzojnë profesionistin ligjor (i cili ka njohuri aktuale për këto dënime) të ndërmarrë aktivitete të caktuara në emër të tyre.
- 14) Klientë që nuk kanë adresë, ose që kanë adresë të shumta pa arsye legjitime.
- 15) Klientë që kanë fonde që janë dukshëm dhe në mënyrë të pashpjegueshme në disproporcion me rrethanat e tyre (p.sh. mosha, të ardhurat, profesioni ose pasuria e tyre).
- 16) Klientë që ndryshojnë udhëzimet e tyre të marrëveshjes ose ekzekutimit pa shpjegime të duhura.
- 17) Klientët që ndryshojnë mjetin e tyre të pagesës për transaksion në minutën e fundit dhe pa arsyetim (ose me arsyetim të dyshimtë), ose ku ka mungesë informacioni ose transparence të pashpjegueshme në transaksion. Ky rrezik shtrihet në situatat kur bëhen ndryshime të minutës së fundit për të mundësuar pagesën e fondeve nga/jashtë një pale të tretë.
- 18) Klientë të cilët këmbëngulin, pa shpjegime të arsyeshme, që transaksionet të kryhen ekskluzivisht ose kryesisht nëpërmjet përdorimit të pasurive virtuale me qëllim të ruajtjes së anonimitetit të tyre.
- 19) Klientët që ofrojnë të paguajnë tarifa jashtëzakonisht të larta për shërbime që zakonisht nuk do të garantonin një prim të tillë. Megjithatë, *bona fide* dhe

marrëveshjet e përshtatshme të tarifave të paparashikuara, ku një profesionist ligjor mund të marrë një çmim të konsiderueshëm për një përfaqësim të suksesshëm, nuk duhet të konsiderohen si një faktor rreziku.

- 20) Nivele të larta jo të zakonshme të aseteve ose transaksione jashtëzakonisht të mëdha në krahasim me atë që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga klientët me një profil të ngjashëm mund të tregoj se klienti që nuk shihet si rrezik më i lartë duhet të trajtohet si i tillë. Në të kundërt, nivelet e ulëta të aksioneve ose transaksionet me vlerë të ulët që përfshijnë një klient që përndryshe do të dukej si klient me rrezik më të lartë, mund të lejojnë që profesionisti ligjor ta trajtojë klientin si klient me rrezik më të ulët.
- 21) Disa transaksione, struktura, vendndodhje gjeografike, aktivitete ndërkombëtare ose faktorë të tjerë që nuk janë në përputhje me të kuptuarit e profesionistit ligjor për situatën e biznesit ose situatën ekonomike të klientit.
- 22) Baza ligjor e profesionale e klientit përfshin industri ose sektorë ku mundësitë për PP/FT-në janë veçanërisht të përhapura<sup>15</sup>.
- 23) Klientët që aplikojnë për të drejta qëndrimi ose shtetësi në një juridiksion në këmbim të transfertave të kapitalit, blerjes së pronave ose obligacioneve qeveritare ose investimeve në subjekte korporative në atë juridiksion.
- 24) Klientë të cilët dyshohet se janë të përfshirë në aktivitete falsifikuese përmes përdorimit të kredive false, faturave false dhe marrëveshjeve mashtruese të emërtimit.
- 25) Marrëdhënia midis numrit të punonjësve/strukturës dhe natyrës së biznesit është divergjente nga norma e industrisë (p.sh., qarkullimi i kompanisë është jashtëzakonisht i lartë duke marrë parasysh numrin e punonjësve dhe aseteve në krahasim me bizneset e ngjashme).
- 26) Klienti që kërkon këshilla ose zbatim të një marrëveshjeje që ka tregues të qëllimit të evazionit fiskal, pavarësisht nëse identifikohet si qëllimi i shprehur i klientit, në ndërlidhje me një skemë të njohur evazionit fiskal ose bazuar në tregues të tjerë nga natyra e transaksionit.
- 27) Transferimi i selisë së një kompanie në një juridiksion tjetër pa ndonjë aktivitet të mirëfilltë ekonomik në vendin e destinacionit paraqet rrezik për krijimin e kompanive guaskë që mund të përdoren për të errësuar pronësinë përfituese.
- 28) Aktiviteti i papritur nga një klient jo aktiv pa shpjegim të qartë.
- 29) Klienti që fillon ose zhvillon një ndërmarrje me profil të papritur ose cikle biznesi jonormale ose klienti që hyn në tregje të reja/në zhvillim. Krimi i



organizuar në përgjithësi nuk ka arsye pse të rrisë kapitalin/borxhin, për ti bërë shpesh këto ndërmarrje të parat në një treg të ri, veçanërisht aty ku ky treg mund të jetë treg intensiv i shitjes me pakicë/ ose në para të gatshme.

- 30) Treguesit që klienti nuk dëshiron të marrë miratimet/deklarimet e nevojshme qeveritare.
- 31) Arsyeja për zgjedhjen e subjektit nga klienti është e paqartë, duke pasur parasysh madhësinë, vendndodhjen ose specializimin e subjektit.
- 32) Ndryshimi i shpeshtë ose i pashpjegueshëm i këshilltarit(ve) profesional ose anëtarëve të menaxhmentit.
- 33) Klienti heziton të japë të gjithë informacionin përkatës ose profesionisti ligjor ka dyshime të arsyeshme se informacioni i dhënë është i mjaftueshëm ose i saktë .
- 34) Klientët që kërkojnë të marrin të drejta rezidente ose shtetësi në vendin e themelimit të profesionistit ligjor, në këmbim të transfereve të kapitalit, blerjes së pronave dhe obligacioneve qeveritare, ose investimeve në subjekte korporative.

#### ***Rreziku i transaksionit/shërbimit***

- 1) Shërbimet ku profesionistët ligjorë, duke vepruar efektivisht si ndërmjetës financiarë, trajtojnë marrjen dhe transmetimin e fondeve, nëpërmjet llogarive që ata kontrollojnë në emër të lehtësimit të transaksionit të biznesit.
- 2) Shërbime që lejojnë klientët të depozitojnë/transferojnë fonde përmes llogarisë së besuar të profesionistit ligjor që nuk janë të ndërlidhura me një transaksion për të cilin profesionisti ligjor bën ose kryen aktivitete të specifikuar në Rekomandimin 22 të FATF-it.
- 3) Shërbime ku klienti mund të kërkojë që transaksionet financiare të ndodhin jashtë llogarisë së besuar të profesionistit ligjor (llogaria e mbajtur nga profesionisti ligjor për klientin) (p.sh., përmes llogarisë së përgjithshme të firmës dhe/ose një llogarie personale ose biznesi të mbajtur nga vetë profesionisti ligjor).
- 4) Shërbime ku profesionistët ligjorë në praktikë mund të përfaqësojnë ose sigurojnë pozitën, reputacionin dhe besueshmërinë e klientit tek palët e treta, pa njohuri proporcionale për punët e klientit.
- 5) Shërbimet që janë në gjendje të fshehin pronësinë përfituese nga autoritetet kompetente.
- 6) Shërbimet e kërkuara nga klienti për të cilat profesionisti ligjor nuk ka ekspertizë me përjashtim të rasteve kur profesionisti ligjor ia referon kërkesën një profesionisti të trajnuar siç duhet për këshilla.

- 7) Shërbime që mbështeten shumë në teknologjitë e reja (p.sh., në lidhje me ofertat fillestare të monedhave ose aseteve virtuale) që mund të kenë dobësi të natyrshme ndaj shfrytëzimit nga kriminelët, veçanërisht ato që nuk rregullohen për aspektet e LPP/LFT-në.
- 8) Transferimi i pasurive të paluajtshme ose mallrave ose pasurive të tjera me vlerë të lartë ndërmjet palëve në një periudhë kohore jashtëzakonisht të shkurtër për transaksione të ngjashme pa ndonjë arsye të dukshme ligjore, tatimore, biznesore, ekonomike ose të tjera legjitime.
- 9) Pagesat e marra nga palë të treta të pashoqëruara ose të panjohura dhe pagesa me para të gatshme ku kjo nuk do të ishte një mënyrë tipike pagese.
- 10) Transaksionet ku është lehtësisht e dukshme për profesionistin ligjor se ka një konsideratë të pamjaftueshme, veçanërisht kur klienti nuk identifikon arsye legjitime për shumën e vlerësuar.
- 11) Marrëveshjet administrative në lidhje me pronat ku i ndjeri ishte i njohur për profesionistin ligjor, si një person i cili ishte dënuar për krime që gjeneronin të ardhura.
- 12) Përdorimi i kompanive guaskë, kompanive me pronësi nëpërmjet aksioneve të emëruara ose aksioneve bartëse dhe kontrolli nëpërmjet të emëruarve dhe drejtorëve të korporatës pa arsye të dukshme ligjore, tatimore, biznesore, ekonomike ose të tjera legjitime.
- 13) Situatat ku këshillat për krijimin e marrëveshjeve ligjore mund të keqpërdoren për të errësuar pronësinë ose qëllimin real ekonomik (përfshirë ndryshimin e emrit/selisë së korporatës ose për krijimin e strukturave komplekse grupe). Kjo mund të përfshijë këshillimin në lidhje me një trust diskrecional që i jep të besuarit fuqi diskrecionale për të emëruar një klasë përfituesish që nuk përfshin përfituesin e vërtetë (p.sh. emërtimi i një bamirësie si përfituesi i vetëm diskrecional fillimisht me synimin për të shtuar përfituesit e vërtetë në një fazë të mëvonshme). Mund të përfshijë gjithashtu situata kur një trust krijohet me qëllim të administrimit të aksioneve në një kompani me synimin për ta bërë më të vështirë përcaktimin e përfituesve të pasurive të menaxhuara nga trusti.
- 14) Shërbimet që janë ofruar qëllimisht ose varen nga më shumë anonimitet në identitetin e klientit ose pjesëmarrësve sesa është normale në rrethanat dhe përvojën e profesionistit ligjor.
- 15) Zgjidhja e vendimeve në mungesë ose zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve bëhet në mënyrë të pazakontë (p.sh., nëse përmbushja e një borxhi shlyerjeje ose gjykimi bëhet shumë lehtë).

- 16) Përdorimi i pasurive virtuale dhe mjeteve të tjera anonime të pagesës dhe transferimit të pasurisë brenda transaksionit pa arsye të dukshme ligjore, tatimore, biznesore, ekonomike ose të tjera legjitime.
- 17) Transaksione që përdorin mjete të pazakonta pagese (p.sh., metale të çmuara ose gurë).
- 18) Shtyrja e një pagese për një aset ose shërbim të dorëzuar menjëherë në një datë larg nga momenti në të cilin normalisht do të pritej të kryhej pagesa, pa garancitë e duhura se pagesa do të kryhet.
- 19) Vendosja e pashpjegueshme e dispozitave të pazakonta në marrëveshjet e kredisë që nuk pasqyrojnë pozicionin tregtar ndërmjet palëve. Marrëveshjet që mund të abuzohen në këtë mënyrë mund të përfshijnë periudha jashtëzakonisht të shkurtra/gjata të amortizimit, norma interesi materialisht mbi/nën normat e tregut, ose anulime të përsëritura të pashpjegueshme të kambialeve/hipotekave ose instrumenteve të tjera të sigurisë, shumë përpara datës së maturimit të rënë dakord fillimisht.
- 20) Transferet e mallrave që janë në thelb të vështira për t'u vlerësuar (p.sh. bizhuteritë, gurët e çmuar, objektet e artit ose antike, pasuritë virtuale), ku kjo nuk është e zakonshme për llojin e klientit, transaksionit ose rrjedhën normale profesionale ligjore të biznesit, si p.sh. transferim tek një subjekt korporativ, ose në përgjithësi pa ndonjë shpjegim të duhur.
- 21) Kapital i njëpasnjëshme ose kontribute të tjera në një periudhë të shkurtër kohore për të njëjtin subjekt pa ndonjë arsye të dukshme ligjore, tatimore, biznesore, ekonomike apo të tjera legjitime.
- 22) Blerjet e bizneseve në likuidim pa ndonjë arsye të dukshme ligjore, tatimore, biznesore, ekonomike apo të tjera legjitime.
- 23) Fuqia e përfaqësimit e dhënë në kushte të pazakonta (p.sh., kur jepet në mënyrë të pakthyeshme ose në lidhje me pasuri të veçanta) dhe arsyet e deklaruara për këto kushte janë të paqarta ose të palogjikshme.
- 24) Transaksionet që përfshijnë persona të lidhur ngushtë dhe për të cilat klienti dhe/ose këshilltarët e tij financiarë japin shpjegime të paqëndrueshme ose të paarsyeshme dhe më pas nuk dëshirojnë ose nuk janë në gjendje t'i shpjegojnë duke iu referuar arsyeve ligjore, tatimore, biznesore, ekonomike ose të tjera legjitime.
- 25) Personat juridikë që, si biznes i veçantë, ofrojnë shërbime TOSHK, duhet të kenë parasysh Trustin dhe Ofruesin e Shërbimeve të Kompanisë (Udhëzuesi

TOSHK),<sup>16</sup> edhe nëse subjekte të tillë juridikë janë në pronësi ose operim nga profesionistë ligjor. Megjithatë, profesionistët ligjorë, , të cilët ofrojnë shërbime TOSHK duhet të kenë parasysh këtë udhëzim dhe duhet të marrin në konsideratë rreziqet e klientit ose të shërbimit që ndërlidhen me TOSHK-të, si në vijim:

- i. Delegimi i pashpjegueshëm i autoritetit nga klienti nëpërmjet përdorimit të autorizimeve, bordeve të kombinuara dhe zyrave përfaqësuese.
  - ii. Sigurimi i objekteve të zyrave të regjistruara dhe posteve drejtoresh të emëruar pa shpjegime të duhura.
  - iii. Përdorimi i pashpjegueshëm i trusteve diskrecionale.
  - iv. Në rastin e besimit të shprehura, një marrëdhënie e pashpjegueshme midis të siguarit dhe përfituesve me të drejtë të dhënë, përfituesve të tjerë dhe personave që janë subjekt i tij.
- 26) Në rastin e një besimit shprehur, natyra e pashpjegueshme (ku shpjegimi nuk justifikohet) e klasave të përfituesve.
  - 27) Shërbime ku profesionisti ligjor vepron si administrues i besuar/drejtor që lejon që identiteti i klientit të mbetet anonim.
  - 28) Situatat ku përdoret një i emëruar (p.sh., një mik ose anëtar i familjes emërohet si pronar i pronës/pasurive ku është e qartë se anëtari/miku i familjes po merr udhëzime nga pronari përfitues), pa ndonjë arsye të dukshme ligjore, tatimore, afariste, ekonomike apo të tjera legjitime.
  - 29) Përdorimi i pashpjegueshëm i llogarive të bashkuar të klientëve ose ruajtje e sigurt e parave ose pasurive të klientit ose aksioneve të bartësit, aty ku lejohet.
  - 30) Transaksionet ose shërbimet tregtare, private ose të pronave të paluajtshme që do të kryhen nga klienti pa arsye të dukshme legjitime, biznesi, ekonomike, tatimore, qeverisjeje familjare apo ligjore.
  - 31) Dyshimi për transaksione mashtruese ose transaksione të cilat nuk janë llogaritur në mënyrë të duhur. Këto mund të përfshijnë:
    - i. Mbi dhe nën faturim të mallrave/shërbimeve.
    - ii. Faturim të shumëfishtë të të njëjtave mallrave/shërbime.
    - iii. Mallra/shërbime të përshkruara në mënyrë të rreme
    - iv. Mbi dhe nën dërgesa (p.sh., hyrje të rreme në faturat e ngarkesës).
    - v. Tregtim të shumëfishtë të mallrave/shërbimeve.

<sup>16</sup> FATF (2019), Udhëzues për qasjen e bazuar në rrezik për trustin dhe ofruesin e shërbimeve të kompanisë (TOSHK), FATF, Paris, [www.fatf-gafi.org/publications/documents/rba-trust-company-service-providers.html](http://www.fatf-gafi.org/publications/documents/rba-trust-company-service-providers.html)

### 14.3 SHTOJCA 3 - LISTA KONTROLLUESE E VLERËSIMIT TË RREZIKUT

Emri i subjektit të raportues: \_\_\_\_\_

Periudha e vlerësimit të rrezikut: \_\_\_\_\_

*Ligji për PPP/LFT* kërkon që institucionet raportuese të kryejnë një vlerësim të rrezikut të ekspozimit tuaj ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe të aplikojnë zbutjen dhe kontrollet përkatëse. Kjo listë kontrolluese ka për qëllim t'ju ndihmojë në përmbushjen e këtyre detyrimeve. Ky formular është paraqitur vetëm si shembull. Ju mund të zgjidhni të kryeni vlerësimin tuaj të rrezikut duke përdorur një qasje të ndryshme.

*Udhëzimet:* Rishikoni klientët me rrezik më të lartë dhe situatat e përshkruara në kolonën e majtë dhe tregoni nëse i keni kryer këto aktivitete gjatë periudhës së vlerësimit të rrezikut. Ju duhet të tregoni shpeshtësinë e secilit lloj transaksioni në kolonën e caktuar. Kur i përgjigjeni po njëërës prej pyetjeve, kjo situatë ose klient konsiderohet me rrezik më të lartë dhe duhet të zbatohet një masë kontrolli për të ulur rrezikun. Për çdo klient apo situatë me rrezik më të lartë, propozohet një masë kontrolli e sugjeruar. Ju mund t'i përshtatni masat e kontrollit që të korrespondojnë me biznesin tuaj (shih Shtojcën C për listën e masave të kontrollit).

Gjatë përcaktimit të shpeshtësisë së transaksioneve, subjekti raportues duhet të bazojë vlerësimin e tij në atë që konsiderohet e shpeshtë në kontekstin e operacioneve të tyre dhe të dokumentojë arsyetimin e tyre.

Rezultatet e këtij vlerësimi të rrezikut duhet të integrohen në rregulloret dhe procedurat e subjekteve raportuese. Në zhvillimin e rregulloreve dhe procedurave që përshtaten me rezultatet e gjetjeve të vlerësimit të rrezikut, institucionet raportuese duhet të marrin parasysh shpeshtësinë dhe materialitetin e transaksioneve me rrezik më të lartë. Fokusi juaj për LPP/LFT-në duhet t'u japë përparësi atyre situatave me rrezik më të lartë që janë më të shpeshta dhe më të mëdha.

Kjo duhet të përfshijë gjithashtu komunikimin me të gjithë punonjësit përkatës për të siguruar që ata të kuptohen në mënyrë të duhur dhe të zbatohen masat e kontrollit. Trajnimi i punonjësve përkatës duhet të përfshijë një prezantim të vlerësimit të rrezikut dhe rolit të punonjësve në zbatimin e masave të kontrollit. Ju duhet të rishikoni vlerësimin tuaj të rrezikut në mënyrë periodike bazuar në ndryshimet në legjislacion ose aktivitetet e biznesit tuaj dhe të paktën çdo dy vjet.

## Vlerësimi i rrezikut

Klientët			
Klientë dhe situata me rrezik më të lartë	Po Frekuenca e lartë e transaksioneve Rrezik më të lartë	Asnjë transaksion Rrezik më të ulët •	Masat e propozuara të kontrollit
A janë klientët tuaj të huaj?		•	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcaktoni nëse individët janë persona të ekspozuar politikisht.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Kryeni kërkimin në internet</li> <li>• Rritja e frekuencës së monitorimit të vazhdueshëm</li> </ul>
Keni klientë që janë persona të ekspozuar politikisht?		•	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni miratimin e menaxhmentit të lartë për të kryer transaksionin.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Monitoroni çdo transaksion të ardhshëm.</li> </ul>

A është klienti juaj një mjet i ndërmjetëm si korporatat, trustet, fondacionet, partneritetet apo struktura të tjera që e bëjnë të vështirë përcaktimin se kush është pronari përfitues?			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni emrin e pronarit përfitues pas korporatës, trustit ose marrëveshjes ligjore.</li> <li>• Merrni informacion shtesë mbi strukturën organizative.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> </ul>
A janë klientët tuaj ndërmjetës (p.sh. avokatë dhe kontabilistë që veprojnë në emër të klientëve)?			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni emrin e personit(ve) në emër të të cilit po kryhet transaksioni.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> </ul>
A është përmendur në media një nga klientët tuaj si i përfshirë në organizata kriminale?			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Paraqisni raportin e transaksionit të dyshimtë (RTD).</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> </ul>
A keni një klient që po kryen një transaksion që nuk është brenda mundësive të tij/saj bazuar në profesionin ose të ardhurat e tij të deklaruara?			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> </ul>
A angazhohen klientët tuaj në aktivitete që janë në përputhje me treguesit e identifikuar për aktivitete të dyshimta?			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni parasysh paraqitjen e një raporti të transaksionit të dyshimtë (RTD).</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> </ul>

<b>Rreziku gjeografik</b>			
<b>Klientë dhe situata me rrezik më të lartë</b>	<b>Po</b>	<b>Asnjë transaksion</b>	<b>Masat e propozuara të kontrollit</b>
	<b>Frekuenca e lartë e transaksioneve</b>	<b>Rrezik më të ulët</b>	
	Rrezik më të lartë		
<p>A e ka ndonjë nga klientët tuaj ose fondet burimore origjinën nga vende që i nënshtrohen sanksioneve, embargove ose masave të ngjashme lëshuar nga Kosova apo Organizata Ndërkombëtare si p.sh nga Organizata e Kombeve të Bashkuara ("OKB").</p> <p>Organizata e Kombeve të Bashkuara: <a href="https://www.un.org/sc/suborg/en/sanctions/un-sc-consolidated-list">https://www.un.org/sc/suborg/en/sanctions/un-sc-consolidated-list</a></p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni miratimin e menaxhmentit të lartë për të vazhduar me transaksionin.</li> <li>• Kërkoni dokumentacion shtesë të identifikimit për të konfirmuar identitetin.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Rritja e frekuencës së monitorimit të vazhdueshëm</li> </ul>



<p>A e ka ndonjë nga klientët tuaj ose fondet burimore origjinën nga vende të identifikuara si parajsë ose juridiksione të sekretit financiar.</p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni miratimin e menaxhmentit të lartë për të vazhduar me transaksionin.</li> <li>• Kërkoni një dokument shtesë identifikimi për të konfirmuar identitetin.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Rritja e frekuencës së monitorimit të vazhdueshëm</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• A e ka ndonjë nga klientët tuaj ose fondet burimore origjinën nga vendet e identifikuara nga Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) si vende me mangësi strategjike në luftën kundër pastrimit të parave ose i nënshtrohen një deklaratë të FATF-së?</li> </ul> <p>FATF: <a href="http://www.fatf-gafi.org/publications/high-riskandnon-cooperativejurisdictions/?hf=10&amp;b=0&amp;s=desc(fatf%20release%20date)">http://www.fatf-gafi.org/publications/high-riskandnon-cooperativejurisdictions/?hf=10&amp;b=0&amp;s=desc(fatf release date)</a></p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni miratimin e menaxhmentit të lartë për të vazhduar me transaksionin.</li> <li>• Kërkoni dokumentacion shtesë identifikimi për të konfirmuar identitetin.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Rritja e frekuencës së monitorimit të vazhdueshëm</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• A e ka ndonjë nga klientët tuaj ose fondet burimore</li> </ul>			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni miratimin e menaxhmentit të lartë për të</li> </ul>

<p>originën nga vende të identifikuara nga burime të besueshme që ofrojnë fonde ose mbështetje për aktivitetet terroriste?</p>			<p>vazhduar me transaksionin.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkoni dokumentacion shtesë identifikimi për të konfirmuar identitetin.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Rritja e frekuencës së monitorimit të vazhdueshëm</li> </ul>
<p>• A e ka ndonjë nga klientët tuaj apo fondet burimore originën nga vende të identifikuara nga burime të besueshme që ofrojnë fonde ose mbështetje për aktivitetet terroriste?</p> <p><a href="http://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2016">http://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2016</a></p>			<p>vazhduar me transaksionin.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni miratimin e menaxhmentit të lartë për të vazhduar me transaksionin.</li> <li>• Kërkoni dokumentacion shtesë identifikimi për të konfirmuar identitetin.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Kryeni kërkime shtesë për klientin.</li> </ul>

Kanali i dorëzimit dhe praktikat e biznesit			
Klientë dhe situata me rrezik më të lartë	Po Frekuenca e lartë e transaksioneve Rrezik më të lartë	Asnjë transaksion Rrezik më të ulët	Masat e propozuara të kontrollit
A pranoni para të gatshme?			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konfirmoni burimin e fondeve</li> <li>• Vendosni kufij për shumat e transaksioneve në para.</li> <li>• Kërkoni garancione bankare në vend që të pranoni shuma të mëdha parash.</li> </ul>
A kryeni transaksione ku nuk takoni klientin?			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofroni trajnime gjithëpërfshirëse për PPP/FT të fokusuar veçanërisht në kërkesat e kujdesit të duhur të klientit</li> <li>• Kërkoni dokumentacion shtesë identifikimi për të konfirmuar identitetin.</li> <li>• Kryeni rishikim periodik të të dhënave për të siguruar që kërkesat e kujdesit të duhur të klientit janë zbatuar në mënyrë adekuate</li> </ul>
A keni klientë që ju referohen			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryeni drejtpërdrejt masat e kujdesit të duhur ndaj</li> </ul>

nga një palë e tretë?			<p>klientit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryeni rishikim periodik të të dhënave për të siguruar që kërkesat e kujdesit të duhur të klientit respektohen nga palët e treta.</li> </ul>
Keni agjentë afatshkurtër ose me kohë të pjesshme?			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfshini detyrimet e PP/FT në përshkrimet e punës dhe rishikimet e performancës.</li> <li>• Ofroni trajnime gjithëpërfshirëse PPP/FT për të gjithë agjentët</li> </ul>
A ndërmerrni transaksione me vlerë të lartë?			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushtojini vëmendje të veçantë treguesve të transaksioneve të pazakonta dhe PP/FT.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Rritja e frekuencës së monitorimit të vazhdueshëm</li> </ul>
<b>Faktorë të tjerë rreziku: (listoni ndonjë faktor shtesë)</b>			
A ofroni produkte ose shërbime që ofrojnë anonimitet?			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërmerr procedura të mëtejshme verifikimi për klientin ose pronarin përfitues</li> </ul>

<p>A ofroni produkte ose shërbime që mund të kalojnë lehtësisht kufijtë ndërkombëtarë (p.sh. para të gatshme, transferta parash në internet, karta me vlerë të ruajtur, urdhërpagesa, transfere ndërkombëtare parash me telefon celular, metale të çmuara ose gurë)</p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcaktoni nëse klientët janë persona të ekspozuar politikisht.</li> <li>• Përcaktoni nëse juridiksioni i destinacionit konsiderohet me rrezik të lartë.</li> <li>• Rritja e frekuencës së monitorimit të vazhdueshëm</li> </ul>
<p>A ofrojnë produktet dhe shërbimet tuaja një shtrirje globale?</p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcaktoni nëse klientët janë persona të ekspozuar politikisht.</li> <li>• Përcaktoni nëse juridiksioni i destinacionit konsiderohet me rrezik të lartë.</li> <li>• Rritja e frekuencës së monitorimit të vazhdueshëm</li> </ul>
<p>A ofroni produkte komplekse ku është e vështirë të identifikohet pronari përfitues?</p>			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërmerr procedura të mëtëjshme verifikimi për klientin ose pronarin përfitues</li> </ul>

A ofroni shërbime që lejojnë shkëmbimin e parave të gatshme për një instrument të negociueshëm (p.sh. karta me vlerë të ruajtur, urdhër parash, çeqe)			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve</li> <li>• Rritja e frekuencës së monitorimit të vazhdueshëm</li> </ul>
A ofroni shërbime që lejojnë shkëmbimin e parave të gatshme për shkëmbimin ose transferimin e fondeve?			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni informacionin e autorit dhe të përfituesit</li> <li>• Rritja e frekuencës së monitorimit të vazhdueshëm</li> </ul>
A jeni i përfshirë në transaksione të pasurive të paluajtshme me vlerë të lartë? <sup>17</sup>			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushtojini vëmendje të veçantë treguesve të transaksioneve të pazakonta dhe PP/FT.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Rritja e frekuencës së monitorimit të vazhdueshëm</li> </ul>
<p><b>Faktorë të tjerë:</b></p> <p>Subjektet e detyruara duhet të listojnë produktet/shërbimet që konsiderohen me rrezik të lartë në sektorin e tyre siç</p>			

<sup>17</sup> Transaksionet mbi 100,000 Euro duhet konsideruar vlerë e lartë. Subjektet raportuese mund të vendosin prag të ndryshëm bazuar në rrethanat e tyre unike, megjithatë pragu duhet të dokumentohet dhe justifikohet në mënyrë adekuate.

përcaktohet nga analiza e tyre e rrezikut ose vlerësimi kombëtar i rrezikut			
---	--	--	--

Faktorët specifikë të rrezikut për profesionistët ligjorë			
Klientë dhe situata me rrezik më të lartë	Po Rrezik më të lartë	Asnjë transaksion Rrezik më të ulët	Masat e propozuara të kontrollit
Transaksione me pasuri të paluajtshme me vlerë të lartë <sup>18</sup>			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushtojini vëmendje të veçantë treguesve të transaksioneve të pazakonta dhe PP/FT.</li> <li>• Merrni informacion mbi burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Rritja e frekuencës së monitorimit të vazhdueshëm</li> </ul>

<sup>18</sup> Transaksionet mbi 10,000 Euro duhet konsideruar vlerë e lartë. Subjektet raportuese mund të vendosin prag të ndryshëm bazuar në rrethanat e tyre unike, megjithatë pragu duhet të dokumentohet dhe justifikohet në mënyrë adekuate.

Menaxhimi i parave të klientit, letrave me vlerë dhe asetëve të tjera			<ul style="list-style-type: none"> <li>• informacion shtesë mbi burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Monitoroni transaksionet dhe aktivitetet</li> <li>• Kushtojini vëmendje të veçantë treguesve të transaksioneve të pazakonta dhe PP/FT.</li> </ul>
Organizimi ose administrimi i kontributeve për krijimin, funksionimin ose menaxhimin e personave juridikë			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni emrin e pronarit përfitues pas korporatës, trustit ose marrëveshjes ligjore.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Monitoroni transaksionet dhe aktivitetet</li> <li>• Kushtojini vëmendje të veçantë treguesve të transaksioneve të pazakonta dhe PP/FT.</li> </ul>
Krijimi, funksionimi dhe menaxhimi i personave juridikë			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni emrin e pronarit përfitues pas korporatës, trustit ose marrëveshjes ligjore.</li> <li>• Merrni informacion shtesë mbi strukturën organizative.</li> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> </ul>



Blerja dhe shitja e subjekteve afariste			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni informacion shtesë për burimin e fondeve ose burimin e pasurisë.</li> <li>• Monitoroni transaksionet dhe aktivitetet</li> <li>• Kushtojini vëmendje të veçantë treguesve të transaksioneve të pazakonta dhe PP/FT.</li> </ul>
Duke vepruar si aksionar i emëruar			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Monitoroni transaksionet dhe aktivitetet</li> <li>• Kushtojini vëmendje të veçantë treguesve të transaksioneve të pazakonta dhe PP/FT.</li> </ul>
Duke vepruar si drejtor, sekretar ose partner i emëruar			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Monitoroni transaksionet dhe aktivitetet</li> <li>• Kushtojini vëmendje të veçantë treguesve të transaksioneve të pazakonta dhe PP/FT.</li> </ul>
Sigurimi i një zyre të regjistruar, adresë biznesi/administrate ose akomodimi			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Monitoroni transaksionet dhe aktivitetet</li> <li>• Kushtojini vëmendje të veçantë treguesve të transaksioneve të pazakonta dhe PP/FT.</li> </ul>

Duke vepruar si agjent neutral (për pasuri të paluajtshme ose ndonjë qëllim tjetër)			<ul style="list-style-type: none"><li>• Merrni informacion shtesë për identifikimin e klientit</li><li>• Merrni emrin e pronarit përfitues pas korporatës, besimit ose marrëveshjes ligjore.</li><li>• Kushtojini vëmendje të veçantë treguesve të transaksioneve të pazakonta dhe PP/FT.</li></ul>
---	--	--	---

---

*Nënshkrimi i zyrtarit të pajtueshmërisë me LPP/FT*

*Data* \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_

*Data e trajnimit të punonjësve:*

---

#### 14.4 SHTOJCA 4 - MASAT PËR ZBUTJEN E RREZIKUT

Masat për zbutjen e rrezikut për situata me rrezik të lartë mund të përfshijnë:

- 1) Rritjen e ndërgjegjësimit për situatat me rrezik më të lartë brenda linjave të biznesit në të gjithë subjektin raportues;
- 2) Rritjen e monitorimit të transaksioneve;
- 3) Miratimin e krijimit të marrëdhënieve të përshkallëzuar tek menaxhmenti i lartë;
- 4) Nivelet e kontroleve dhe rishikimeve të vazhdueshme të marrëdhënieve janë rritur;
- 5) Stafin që ka linja të qarta autoriteti, përgjegjësie dhe llogaridhënieje;
- 6) Ndarjen adekuate të detyrave (për shembull, një punonjës që krijon një marrëdhënie me një klient nuk është i autorizuar gjithashtu ta miratojë atë pasi autorizimi është përgjegjësi e dikujt tjetër në organizatë);
- 7) Procedurat e duhura për autorizim (për shembull, një punonjës që përpunon një transaksion për të cilin shuma tejkalon një prag të caktuar duhet të ndjekë një procedurë për të marrë miratimin për transaksionin nga dikush tjetër në organizatë);
- 8) Rishikime të brendshme për të vërtetuar proceset e vlerësimit të rrezikut;
- 9) Kërkimin e informacionit shtesë, përtej kërkesave minimale për të vërtetuar identitetin e klientit ose pronësinë përfituese të një subjekti;
- 10) Marrjen e informacionit shtesë për natyrën e synuar të marrëdhënies, duke përfshirë vlerësimet në lidhje me sasinë dhe llojin e aktivitetit të biznesit;
- 11) Marrjen e informacionit shtesë të dokumentuar në lidhje me burimin e fondeve të klientit dhe akumulimin e pasurisë;
- 12) Kërkimin e klientëve me rrezik të lartë për të ofruar informacion shtesë, të dokumentuar në lidhje me kontrollet që ata kanë zbatuar për të mbrojtur operacionet e tyre nga abuzimi nga pastruesit e parave dhe terroristët;
- 13) Marrjen e verifikimit të pavarur të informacionit (p.sh. nga një burim i besueshëm i ndryshëm nga klienti);
- 14) Ndalimin e çdo transaksioni me një klient potencial derisa të merret informacioni identifikues;
- 15) Zbatimin e një procesi të përshtatshëm për të miratuar të gjitha marrëdhëniet e identifikuar si me rrezik të lartë si pjesë e procesit të pranimit të klientit ose që refuzojnë të bëjnë biznes me klientët potencialë për shkak se ato tejkalojnë nivelin tuaj të tolerancës ndaj rrezikut;
- 16) Zbatimin e një procesi për të dalë nga një marrëdhënie ekzistuese me rrezik të lartë, e cila është përtej nivelit të deklaruar të tolerancës ndaj rrezikut të njësisë ekonomike; dhe
- 17) Analizimin e dobësive të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për proceset e reja të blerjes dhe për proceset e zhvillimit të produkteve ose shërbimeve.

### 13. KONKLUZIONET

Subjektet raportuese inkurajohen të zbatojnë udhëzimet e dhëna në këtë dokument për të mbrojtur veten nga PP/FT, por edhe për të siguruar integritetin e profesionit të tyre.

Dokumenti udhëzues është strukturuar për t'u ofruar profesionistëve ligjorë një përmbledhje të koncepteve kyçe të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, rrezikut dhe sfidave ndaj të cilave mund të ekspozohen profesionet ligjore, të ofrojë raste studimore të rasteve të PP/FT-së në profesionin ligjor si dhe të nënvizojë hapat konkretë se si këto mund të zbuten dhe menaxhohen në mënyrë efektive. Obligimet e LPP/LFT-së janë të përmbledhura dhe të shoqëruara me kritere vlerësimi që shpjegojnë se çfarë do të presë NjIF-i gjatë kryerjes së inspektimeve. Këto kritere vlerësimi u ofrojnë profesionistëve ligjorë një pasqyrë të qartë se çfarë duhet bërë kur zbatojnë detyrimet e tyre për LPP/LFT.

Udhëzuesi thekson se është përgjegjësi e menaxhmentit të lartë të profesionistëve ligjorë për të krijuar dhe promovuar një kulturë pajtueshmërie. Ata duhet të sigurojnë që profesionistët ligjorë janë të përkushtuar për të menaxhuar dhe zbutur rreziqet e PP/FT-së gjatë krijimit ose mbajtjes së marrëdhënieve.

Shtojcat janë përgatitur për t'u ofruar profesionistëve ligjorë këshilla konkrete se si të konstatojnë rrezikun e PP/FT brenda subjekteve të tyre.

#### 14. BIBLIOGRAFIA

FATF (2019), *Udhëzues për qasjen e bazuar në rrezik për profesionistët ligjorë*, FATF, Paris, në dispozicion në: [www.fatf-gafi.org/publications/documents/Guidance-RBA-legal-professionals.html](http://www.fatf-gafi.org/publications/documents/Guidance-RBA-legal-professionals.html), qasur më 27 korrik 2022

FATF (2012-2022), *Standardet Ndërkombëtare për Luftimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe Përhapjes*, FATF, Paris, Francë, përditësuar në mars 2022, në dispozicion në: [www.fatf-gafi.org/recommendations.html](http://www.fatf-gafi.org/recommendations.html), qasur më 27 korrik 2022

FATF (2013-2021), *Metodologjia për vlerësimin e pajtueshmërisë me rekomandimet e FATF dhe efektivitetin e sistemeve LPP/LFT*, përditësuar tetor 2021, FATF, Paris, Francë, në dispozicion në: <http://www.fatf-gafi.org/publications/mutualevaluations/documents/fatf-methodology.html>, qasur më 27 korrik 2022

*Vlerësimi i rrezikut kombëtar të Kosovës për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit*, gusht 2020.

BE/Këshilli i Evropës (2018) *Raporti i vlerësimit mbi pajtueshmërinë e Kosovës me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit*, (Projekti kundër Krimin Ekonomik në Kosovë\* PECK II, 2018. Gjetet në: <https://rm.coe.int/assessment-report-on-compliance-of-kosovo-with-international-anti-mone/16809381e1>, qasur më 27 korrik 2022.